



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**STRATEGJIA
KOMBËTARE
E ARSIMIT
2004 - 2015**

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA..... | 4 |
| HYRJE..... | 5 |
| PJESA A | |
| PRIORITETET PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR | 7 |
| A.1 QEVERISJA-REFORMIMI DHE FORCIMI I KAPACITETEVE MENAXHUESE...7 | |
| A.1.1 Reformimi i MASH..... | 7 |
| A.1.2 Decentralizimi..... | 7 |
| A.1.3 Autonomia e shkollave..... | 8 |
| A.1.4 Sistemi i menaxhimit të informacionit në sektorin e arsimit (EMIS) | 8 |
| A.1.5 Raportimi dhe sigurimi i cilësisë..... | 9 |
| A.2 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PROCESIT MËSIMOR (MËSIMDHËNIE/NXËNIE) | 9 |
| A.2.1 Zhvillimi i kurrikulës | 10 |
| Korniza kurrikulare kombëtare | |
| Racionalizimi i lëndëve | |
| Brendia. Integrimi vertikal dhe horizontal | |
| Struktura e kurrikulës së arsimit parauniversitar | |
| Zgjedhja e lëndëve nga nxënësit dhe kurrikula gjithpërfshirëse | |
| A.2.2 Zhvillimi i profesionit të mësimdhënies | 12 |
| Parashikim më i mirë i kërkesës për mësues | |
| Forcimi i Qendrës së Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin | |
| Përmbajtja/procesi i kurrikulës për trajnimin e mësuesve, etj | |
| Skema motivuese të punësimit të bazuara në meritat | |
| Shqyrtimi i modeleve të reja dhe alternative të trajnimit të mësuesve | |
| Sigurimi i cilësisë/regjistrimi i mësuesve | |
| Trajnimi i mësuesve gjatë punës dhe rrejetet profesionale | |
| A.2.3 Tekstet shkollore | 13 |
| Përzgjedhje më e mirë e përmbajtjes dhe strukturës shpjeguese | |
| Kordinimi i kërkesës dhe ofertës për tekstet shkollore | |
| Menaxhimi i kërkesës dhe ofertës për tekstet alternative | |
| Privatizimi | |
| Mbulimi i kostos | |
| A.2.4 Burimet alternative të mësimdhënies | 14 |
| A.2.5 Provimet dhe vlerësimet..... | 15 |
| Forcimi i kapaciteteve | |
| Monitorimi i cilësisë dhe përdorimi i treguesve ndërkombëtarë | |
| Zhvillimi dhe menaxhimi i provimeve kombëtare | |
| A.3 FINANCIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR | 16 |
| A.3.1 Instrumentat dhe proceset për transferimin e fondeve..... | 16 |
| Modeli “për nxënës” i financimit | |
| Financimi i Qeverisë Vendore | |
| Menaxhimi i shpenzimeve korrente nga MASH | |
| Përgjegjshmëria dhe transparencë | |
| Kapaciteti i planifikimit të buxhetit | |
| A.3.2 Rritja e efikasitetit në financimin e nënsektorit | 18 |
| Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit | |

| | |
|--|----|
| Mbledhja e të ardhurave për shkollat | |
| Përfundimi nga taksat i investimeve në arsim | |
| Rialokimi i fondeve. | |
| A.3.3 Sistemet e ekspertizës dhe mbështetjes së reformës së propozuar | 19 |
| A.4 KRIJIMI I KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE – NDRYSHIMI KONCEPTUAL | 19 |
| A.4.1 Arsimit si shërbim ndërsektoral | 19 |
| A.4.2 Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave | 20 |
| A.4.3 Inspektimi dhe ndihma | 20 |
| A.4.4 Profesionalizimi i mësimdhënies..... | 20 |
| A.4.5 Lëndët me zgjedhje dhe specialitetet | 21 |
| A.4.6 Zhvillimi i politikave të bazuar në kërkim dhe të orientuar nga të dhënat..... | 21 |
| A.5 ZHVILLIMI I ARSIMIT PROFESIONAL | 22 |
| A.5.1 Panoramë e përgjithshme e Arsimit Profesional | 22 |
| A.5.2 Karakteristikat kryesore dhe problematika e AP | 22 |
| A.5.3 Objektivat strategjike të Arsimit Profesional | 24 |
| PJESA B | |
| MATRICA E POLITIKËS: ÇËSHTJET E RËNDËSISHME, OBJEKTIVAT, PËRFITUESIT, INDIKATORËT MONITORUES DHE AFATET KOHORE | 27 |
| B.1 QEVERISJA - REFORMIMI DHE FORCIMI I KAPACITETIT MENAXHUES..... | 27 |
| B.2 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PROCESIT MËSIMOR (MËSIMDHËNIE/ NXËNIE). 29 | |
| B.3 REFORMA FINANCIARE PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR | 31 |
| B.4 KRIJIMI I KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE KALIMI KONCEPTUAL | 33 |
| PJESA C | |
| PLANI I ZBATIMIT | 36 |
| C.1 QEVERISJA-REFORMIMI DHE FUQIZIMI I KAPACITETIT MENAXHUES | 37 |
| C.2 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË PROCESIT MËSIMOR (MËSIMDHËNIE/ NXËNIE) | 39 |
| C.3 FINANCIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR..... | 41 |
| C.4 KRIJIMI I KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE..... | 42 |
| PJESA D: | |
| PËRMBLEDHJE E PREVENTIVIT TË KOSTOVE | 44 |
| PJESA E | |
| MATRICAT E INPUT-it TË BURIMEVE | 45 |
| E.1 Qeverisja-reformimi dhe forcimi i kapaciteteve menaxhuese | 48 |
| E.2 Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor | 49 |
| E.3 Financimi i arsimit parauniversitar | 51 |
| E.4 Krijimi i kapaciteteve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore | 53 |

LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

BB Banka Botërore
BE Bashkimi Europian
CARDS Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
DAR Drejtoria Arsimore Rajonale
EFA Arsimi për të Gjithë
EMIS Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim
GDP Produkti Kombëtar Bruto
IKS Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve
ILO Organizata Botërore e Punës
INSTAT Instituti i Statistikave
LSMS Studimi Vlerësues i Standardit të Jetesës
MASH Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MBP Menaxhimi në bazë të performancës
MPVD Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
OECD Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJF Organizatë Jofitimprurëse
PV Pushteti Vendor
QKAVP Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve
QTKA Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin
SAPP Sektori i Analizës së Politikave dhe Planifikimit
SKZHAP Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
SKZHES Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social
TIK Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNICEF Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
ZA Zyrë Arsimore

HYRJE

Kjo Strategji mbështetet në dokumentin "Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015", i miratuar nga Qeveria shqiptare në qershor 2004.

Ndryshimet kryesore të kësaj Strategjie në krahasim me atë dokument janë:

- Është shtuar kapitulli i strategjisë së arsimit profesional;
- Është shtuar një pjesëz e posaçme për shërbimin privat arsimor;
- Nuk janë përfshirë ato fjali të cilat bëjnë fjalë ngushtësisht për veprimtarinë ose pikëpamjet e një qeverie të caktuar.

Strategjia Kombëtare e Arsimit është frut i kontributeve disaveqare i specialistëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe i mësuesve e menaxherëve tanë arsimorë. Ne i falenderojmë ata për zemërsisht.

Një mirënjohje e posaçme u përket institucioneve prestigjioze ndërkombëtare e në vçanti Bankës Botërore për asistencën e pazëvendësueshme që dhanë në hartimin e kësaj Stregjie dhe po japin në zbatimin e saj.

Kjo Strategji ka vlerën e një e një platforme kombëtare, brenda të cilës të gjitha grupet e interesit do të mund të japin kontributin e tyre. Ajo konkretizon një nga përpjekjet më të rëndësishme për angazhimin intensiv profesional, vendosjen e dialogut gjithpërfshirës dhe mirëkuptimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Strategjia synon të garantojë një sistem arsimor kombëtar e modern, i cili të nxitë rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe konsolidimin e demokracisë, si dhe suksesin në dialogun dhe kompeticionin me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Ky dokument është përvijuar pas këshillimeve të gjera dhe intensive me përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, si mësues, menaxherë arsimorë, prindër, nxënës, OJF, sindikatat, intelektualë, etj.

Dokumenti është strukturuar në bazën e disa pjesëve kryesore:

PJESA A identifikon fushat prioritare në zhvillimin e arsimit parauniversitar në Shqipëri. Kjo pjesë paraqet pikat e forta dhe të dobta dhe sugjeron veprime të mundshme, që synojnë të forcojnë pikat e forta dhe të eliminojnë ato të dobtat. Diskutimet në këtë strategji udhëhiqen nga parimet dhe praktikrat më të mira të zhvillimit të arsimit, siç reflektohen në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe në vendet e BE. Në pjesën A

identifikohen 4 çështje me rëndësi jetike, të cilat janë: qeverisja dhe menaxhimi i arsimit, përmirësimi i cilësisë së mësimnxënies, financimi i arsimit dhe zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e strategjisë kombëtare të arsimit.

PJESA B specifikon, për çdo çështje të trajtuar në pjesën A, objektivat dhe përfituesit, monitorimin e treguesve, rreziqet dhe supozimet, si dhe afatet në formën e matricave të politikave. Ky informacion është nxjerrë nga përshkrimet e fushave prioritare respektive në pjesën A dhe përmbledhet në katër matrica të ndryshme.

PJESA C përmban planin e zbatimit dhe parashikon afatet, si dhe rradhën e veprimtarive të përshkruara në pjesët A dhe B. Informacioni është strukturuar në katër fusha prioritare dhe çdo fushë trajtohet më vetë¹.

PJESA D paraqet një përmbledhje të preventivit të kostos për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar. Preventivi bazohet në kostot e njësive të mbledhura nga një sërë burimesh si MASH, Projekti i BB dhe nga OJF-të.

PJESA E pasqyron Matricën e Inputit të Burimeve dhe supozimet e përdorura në paraqitjen dhe llogaritjen e preventivit të kostove.

¹Strategjia Kombëtare e Arsimit është një dokument në nivel makro dhe, si i tillë, nuk merr përsipër të trajtojë detajet në nivel mikro të të gjitha aktiviteteve dhe procedurave të lidhura me të. Në procesin e zbatimit të kësaj strategjie do të hartohen projekte plotësuese.

A - PRIORITETET PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

A1 Qeverisja - Reformimi dhe forcimi i kapaciteteve menaxhuese

Zbatimi i një modeli menaxhimi ende tepër të centralizuar në qeverisjen e vendit në përgjithësi dhe në fushën e shërbimeve në veçanti, sjell uljen e efektivitetit dhe të efijencës së administratës publike. Ndërsa ristrukturimi formal kah decentralizimi ka shënuar progres të dukshëm në disa sektorë, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, ritmet e decentralizimit të përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror drejt atij vendor në këtë sektor nuk janë të kënaqshme sidomos në arsimin parauniversitar.

A1.1 *Reformimi i MASH*

Ndërsa një ristrukturim i MASH është realizuar nën asistencën e Bankës Botërore dhe disa hapa janë hedhur në riorganizimin e nivelit të dytë (DAR dhe ZAR), sfida pasuese është funksionimi i sistemit menaxhues të performancës në të gjitha nivelet e qeveri-sjes arsimore. Kjo nënkupton rritjen e transparencës për rolet e vendeve të punës në të gjithë piramidën administrative dhe qartësimin më të mirë të detyrave, përgjegjësive dhe detyrimeve reciproke institucionale për secilin vend pune. Kjo do të rrisë shkallën e performancës së çdo individi të angazhuar në menaxhimin e sistemit. Theksojmë se ndërhyrja do të marrë parasysh veprimet dhe procedurat e nevojshme për të siguruar dhe ruajtur nivelin minimal të performancës. Sistemi do të sigurojë raportimin dhe auditimin në disa drejtime, duke rritur në këtë mënyrë transparencën për veprimtarinë e tij. Ai do të sigurojë krijimin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm brenda sistemit të menaxhimit. Në një periudhë afatshkurtër, MASH do të operojë sipas mo-delit të menaxhimit me bazë performance dhe më pas do të kalohet në nivel rajonal (drejtoritë arsimore), lokal dhe deri në nivel dhe shkolle. Modelet me bazë performan-ce do të përdoren për të krijuar përgjegjësi individuale më të mëdha për vetëzhvillim dhe novacione.

A.1.2 Decentralizimi

Decentralizimi në sektorin e arsimit do të sigurojë zgjerimin e pjesëmarrjes dhe rritjen e efektivitetit të grupeve të interesit në përvijimin e projekteve arsimore dhe zbatimin e tyre.

Një projekt i detajuar tanimë për decentralizimin është një mbështetje e rëndësishme për realizimin e këtij procesi. Sipas tij MASH, në bashkëpunim me ministri të tjera dhe me mbështetjen e organizmave ndërkombëtare, do të realizojë delegime të përgjegjësi-ve qarqeve, drejtorive arsimore rajonale, zyrave arsimore, bashkive e komunave, si dhe shkollave.

Platforma e zbatimit synon:

- ndarjen e përgjegjësi-ve funksionale në sektorin e arsimit ndërmjet niveleve të qeverisjes;
- identifikimin e kushteve për të rritur përgjegjësinë mbi funksionet që priten të decentralizohen, nga niveli qendror në nivelin shkollë.

Ky proces do të realizohet përmes një balance të kujdeshme ndërmjet centralizimit dhe decentralizimit, shoqëruar me ndërgjegjësimin për rreziqet dhe mundësitë e suksesit.

A.1.3 Autonomia e shkollave

Nën këtë sistem të decentralizuar, shkollave do t'u kërkohet të marrin përgjegjësi të mëdha në planifikimin, menaxhimin dhe përmirësimin cilësor të shërbimeve që ato sigurojnë. Aktualisht, strukturat dhe personeli ekzistues kanë kapacitete të kufizuara për ta kthyer këtë në realitet. Komunitetet lokale dhe prindërit në të kaluarën janë përfshirë shumë pak në planifikimin e veprimtarive shkollore dhe zgjidhjen e problemeve eventuale që shoqëronin procesin mësimor, prandaj ata e ndjejnë jo si duhet përgjegjësinë për zhvillimin dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga shkollat.

Realizimi i autonomisë shkollore përfshin ndryshimin e një pjese të legjislacionit. Legjislacioni aktual nuk inkurajon dhe nuk mbështet sa duhet pjesëmarrjen e prindërve apo drejtorëve të shkollave për të marrë iniciativa novatore që lidhen me përmirësimin e kushteve të punës në shkollat e tyre.

Skema e granteve për shkollat, si element thelbësor i autonomisë shkollore do të favo-rizojë krijimin e kapaciteteve në shkolla dhe në nivel rajonal për planifikimin dhe bu-xhetimin. Këto kapacitete do të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme në të tre nivelet e arsimit parauniversitar . Me gjithë luhatjet, që mund të shoqërojnë procesin, progresi kah autonomia shkollore do të jetë i qëndrueshëm në 10 vitet e ardhshme. Kjo reformë do të sigurohet edhe duke formuar grupe shkollash te vogla, që do t'i ndajnë midis tyre aftësitë që të çojnë

në autonomi. Këto shkolla do të shërbejnë gjithashtu për të pilotuar përvojat e reja të tyre, në mënyrë që të testohet modeli i decentralizimit në arsim.

A.1.4 Sistemi i menaxhimit të informacionit në sektorin e arsimit (EMIS)

Baza jo e plotë e të dhënave paraqet pengesa të mëdha në zhvillimin e politikave dhe procedurave për përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor. Me asistencën e BB, në MASH është krijuar Sektori i Analizës së Politikave dhe Planifikimit (SAPP), si njësi kyçe në analizën e të dhënave dhe zhvillimin e politikave arsimore. Ky sektor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Informacionit dhe Statistikës në MASH, do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtësisht me INSTAT, për përcaktimin e kategorive dhe niveleve të përpunimit të të dhënave që do të grumbullojë sistemi arsimor e më gjerë. Projekti i BB ka mbështetur gjithashtu zhvillimin e një sistemi EMIS, i cili do të ndihmojë SAPP në arritjen e detyrave të veta.

Sistemi EMIS nënkupton edhe kërkimin konceptual dhe hetimin analitik të të dhënave për qëllime studimore. EMIS duhet të ketë kapacitetin për të kategorizuar të dhënat ekonomike, infrastrukturore, sociale (duke përfshirë grupet e minoritetit) dhe arsimore sipas niveleve: rural, urban dhe qendror, qarku, bashkie/komune, deri në nivel shkolle.

Njësia e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit duhet të fuqizohet dhe të rritë veprimtarinë e vet në disa drejtime:

- informacioni, që do të grumbullohet, duhet të përfaqësojë një sistem unik të dhë-nash, përta i takon nomenklaturës dhe shkallës së përpunimit;
- nomenklatura e të dhënave, që do të grumbullohen, duhet të jetë përgjegjësi e MASH dhe e miratuar në nivelin më të lartë;
- besueshmëria dhe plotësimi i informacionit duhet të konfirmohen edhe nëpërmjet bashkëpunimit institucional me INSTAT;
- informacioni i grumbulluar të konsiderohet pronësi institucionale në shërbim të sistemit.

A.1.5 Raportimi dhe sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë së shërbimeve arsimore kërkon një ndryshim filozofik thelbësor, i cili nuk ka të bëjë vetëm me bërjen e politikave, por edhe me monitorimin.

Vetëvlerësimi i individit ose strukturave të caktuara të sistemit, është një mjet matës i fuqishëm dhe një procedurë e shpejtë vlerësimi që duhet të përdoret

sa më dendur. Për të arritur besueshmërinë për rezultatet e bazuara në metodën e vetëvlerësimit, duhet të alternohet monitorimi periodik i jashtëm me atë të brendshëm. Një monitorim i tillë i koordinuar (i jashtëm dhe i brendshëm) lejon të bëhet në shkallë kombëtare dhe ndër-kombëtare krahasimi i cilësisë së performancës nga ana e menaxherëve dhe speciali-stëve të arsimit, administratorëve, etj. Ky sistem i dyfishtë monitorimi do të disponojë dhe shfrytëzojë mënyra të shumta për raportim dhe auditim me qëllim që të rritet transparenca e procesit dhe besueshmëria e përfundimeve të arritura. Ai do të shoqërohet nga mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e cilësisë së auditimit.

Monitorimi i brendshëm i performancës së shkollës mundëson ndërmarrjen e veprime-ve të efektshme për përmirësime në formën e asistencës nga njësitë e specializuara lokale dhe kombëtare. Nëse një shkollë nuk arrin të përmbushë standardet e veta dhe objektivat e arritjeve të nxënësve, të përcaktuara në planet e veta zhvillimore, atëherë përgjegjësia i mbetet stafit pedagogjik dhe drejtuesve të shkollës. Në raste të tilla, qeveria vendore, e bazuar në përgjegjësitë e transferuara në kuadër të decentralizimit të sektorit arsimor, mund të kufizojë përgjegjësitë e deleguara te shkolla dhe të shpërndajë bordin e shkollës.

Organizimi i inspektimit me dy nivele, qendror dhe lokal, është një hap tjetër drejt krijimit të strukturave që raportojnë cilësinë.

A.2 Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor (mësimdhënie / nxënie)

Pas ndryshimit të sistemit politiko - ekonomik, iniciativat qeveritare për zhvillimin social dhe ekonomik orientuan ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe instalimin e ekonomisë së tregut.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social parashikon objektiva afatgjata e afatmesme për rritjen e qëndrueshme ekonomike, reduktimin e varfërisë dhe të problemeve sociale. Realizimi i këtyre objektivave kërkon në radhë të parë reformimin e sistemit arsimor, për ta përdorur si mbështetje reale për realizimin e iniciativave qeveritare.

Duke qenë se kurrikula dhe procesi mësimor përfaqësojnë bazën e sistemit arsimor, përmirësimet e sistemit arsimor nisin pikërisht me rishikimin e kurrikulës dhe modernizimin e procesit mësimor. Kështu, qysh nga viti 1993, kurrikula e arsimit parauniversitar, procesi i mësimdhënie-mësimnxënies kanë qenë dhe janë objekt ndryshimesh dhe përmirësimesh të vazhdueshme, ndonëse jo përherë shumë të organizuara dhe të mirëmenduara.

Për të rritur nivelin e arsimimit të qytetarëve, aktualisht po zbatohet një strukturë e re e arsimit parauniversitar. Në strukturën e rishikuar 5+4+3, arsimit i

detyrueshëm falas do të zgjasë 9 vjet (nga 8 vjet që ka qenë deri tani)². Zbatimi i strukturës së mësipërme do ta afrojë sistemin arsimor shqiptar me atë të shumicës së vendeve të tjera të Ballkanit, të BE dhe të vendeve të OECD.

Dy nivelet e para përqendrohen në shkrim e lexim, matematikë, njohuri për shoqërinë e shëndetin si dhe në përvetësimin e njohurive dhe aftësive për të qenë pjesë aktive në një shoqëri demokratike të bazuar në njohuritë. Niveli i arsimit të mesëm do të ndërtohet duke u bazuar në nivelin e arsimit të detyruar dhe do të zhvillojë njohuritë e nxënësve për jetën e përditëshme në një ekonomi tregu të një bote demokratike. Në këtë nivel degëzohen dy drejtime. Drejtimi i parë i përgatit nxënësit për të vazhduar shkollën e lartë, ndërsa drejtimi tjetër i pajis ata me aftësitë e shkathtësitë profesionale të nevojshme, për tu bërë anëtarë produktivë të shoqërisë, qysh me mbarimin e shkollës së mesme.

A.2.1 Zhvillimi i kurrikulës

Korniza kurrikulare kombëtare

MASH ka kryer herë pas here përmirësime të kurrikulës duke filluar qysh nga viti 1994. Megjithë hapat pozitivë të kryera në disa drejtime, mbetet ende shumë punë për të konceptuar dhe zhvilluar një kurrikul të kompletuar e veçanërisht për hartimin dhe zbatimin e **kornizës kurrikulare kombëtare** dhe të politikave kurrikulare kombëtare.

Institucionet e varësisë si Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve (IKS), Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin (QTKA) dhe Qendra Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve (QKAVP), që financohen dhe marrin objektivat kryesore të punës nga MASH, konsiderohen si ingranazhet e një mekanizmi të vetëm në për përmirësimin të cilësisë së shërbimit arsimor. Në këto rrethana MASH, krahas monitorimit dhe vlerësimit të punës së kryer, nxjerrjes së përgjegjësisë institucionale në të gjitha nivelet e sistemit, duhet të sigurojë kualifikimin e stafeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të këtyre njësive. Hartimi dhe zbatimi i politikave për raportimin dhe monitorimin e rezultateve të zhvillimit kurrikular në këto njësi synon ta kthejë zhvillimin e kurrikulave në një profesion permanent e me kohë të plotë.

Racionalizimi i lëndëve

Tanimë është i domosdoshëm konceptimi dhe zhvillimi i një modeli kurrikular të orientuar nga kërkesa dhe i fokusuar në njohuritë dhe aftësitë e mjaftueshme për qytetarët aktivë të një shoqërie demokratike të bazuar në ekonominë e tregut. Realizimi i kësaj kërkesë dikton kalimin nga metoda ekzistuese "kurrikula me bazë lëndësh", në "kurrikulën e bazuar në rezultatet e

² Tre nivelet e mësipërme (cikli i ulët, cikli i lartë dhe ai i mesëm) nuk përfshijnë arsimin parashkollor.

të nxënit", sipas së cilës hapen opsione për lëndë të reja dhe/ose integrimin e lëndëve.

Brendia. Integrimi vertikal dhe horizontal

Një nga shkaqet që favorizon dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit në nivelin parauniversitar është mungesa e interesit të këtyre të fundit për mësimin³. Për këtë arsye është e nevojshme të përshtatet procesi mësimor dhe përmbajtja kurrikulare me kërkesat e zhvillimit të fëmijëve dhe me aspiratat e nxënësve dhe të prindërve. Integrimi i lëndëve është një nga përvojat që e bëjnë procesin e nxënies më efektiv në vitet e shkollimit bazë. Veç kësaj, integrimi lëndor do të ulë edhe numrin e teksteve shkollorë, pra, nga një për çdo lëndë, në një numër më të kufizuar tekstesh, duke menaxhuar kështu më mirë impaktin e kostos në arsimin parauniversitar.

Krahasuar me treguesit e ngarkesës për vendet e OECD, ngarkesa mësimore aktuale e nxënësve tanë është shumë e lartë. Kështu, reforma kurrikulare duhet ta trajtojë me përparësi aspektin cilësor të mësimdhënie-mësimnxënies në raport me atë sasi, si dhe t'u sigurojë nxënësve më shumë kohë, të kultivojë te ata shprehjet eksperimentue-se, të rrisë ambicien për kërkim e të zhvillojë operacionet mendore të analizës dhe sintezës gjatë procesit mësimor.

Struktura e kurrikulës së arsimit parauniversitar

Ndryshimi i strukturës së sistemit parauniversitar (5 vite arsimit fillor, 4 arsimit i mesëm i ulët dhe 3 arsimit i mesëm i lartë) dikton rishikimin e strukturës kurrikulare për të zgjidhur problemet që shtrihen koha si dhe për ta afruar atë me vendet e rajonit dhe të BE. Brenda strukturës së propozuar ka lindur nevoja për një integrim vertikal të koncepteve. Inicimi i praktikës së **lëndëve me zgjedhje** kërkon të planifikohet në mënyrë të kujdesshme, për të garantuar zhvillimin gradual të specializimit dhe artikulimit në programet universitare.

Zgjedhja e lëndëve nga nxënësit dhe kurrikula gjithpërfshirëse

Zhvillimet e brendshme dhe kërkesa e afrimit me komunitetin europian diktojnë nevojën për rritjen e fleksibilitetit në hartimin e kurrikulës, në mënyrë që shkollat ose niveli lokal ta përshtasin atë, në masën që u lihet në dispozicion, me nevojat dhe kërkesat e zhvillimit perspektiv lokal ose të traditës. Politikat që udhëheqin përdorimin e lëndëve me zgjedhje dhe të grup-lëndëve, i shërbejnë forcimit të këtij fleksibiliteti. Bordi i shkollës miraton politikën e kurrikulës në

³ LSMS 2002

nivel shkolle, ndërsa qeveria vendore, nëpër-mjet aplikimit të grantit në shkolla, ka rastin t'u japë prioritet projekteve kurrikulare të specifikuara.

Shërbimi privat arsimor

Qysh nga lejimi i hapjes së shkollave private më 1995, ato janë zgjeruar me një ritëm të moderuar duke arritur që në vitin 2004 të përfshijnë: 5 % të fëmijëve në arsimin parashkollor; 3,7 % (3 % në arsimin bazë, 6 % në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe 7 % në arsimin e mesëm profesional) të nxënësve në arsimin parauniversitar dhe 2 % të studentëve. Ndërkohë janë privatizuar disa shërbime arsimore si publikimi, shtypja dhe shpërndarja e teksteve shkollore, po ashtu ndërtimi, rehabilitimi e mirëmbajtja e godinave arsimore.

Ndjekja e këtyre shkollave nuk i detyrohet larmisë së ofertës kurrikulare, pasi ndryshimet e pakta nga shkollat publike kufizohen kryesisht në përfshirjen e informatikës dhe të gjuhës angleze më herët ose të një gjuhe të huaj më tepër. Ndjekja e këtyre shkollave paraqitet më shumë si një kundërveprim ndaj cilësisë së ulët të shkollave publike dhe kjo falë numrit më të vogël të nxënësve për klasë, pajisjeve më të mira me laboratorë dhe mjete të tjera didaktike, gjithashtu një personeli mësimor të përzgjedhur. Megjithëse nuk ka ende një konfirmim zyrtar të arritjeve krahasuese të nxënësve të shkollave private me ato publike, është i pranishëm rreziku që në disa nga këto shkolla interesat e biznesit arsimor të zbehin cilësinë e shërbimit arsimor.

Përqëndrimi i shkollave private në disa qytete më të mëdha ka kufizuar fort aksesin ndaj tyre sidomos për zonat rurale, kurse çmimet përgjithësisht të larta, i bëjnë ato një privilegj të shtresave të kamura.

Shërbimi privat është një nga mënyrat e rritjes së ofertës ndaj interesave dhe nevojave të ndryshme të klientëve arsimorë. Për këtë arsye të parë shërbimi privat arsimor do të inkurajohet përmes:

- Shtimit të shkollave private të të gjitha niveleve,
- Shtimit i larmisë së tyre,
- Zgjerimit të llojeve të shërbimeve të tjera arsimore.

Një arsye tjetër e zgjerimit të shërbimit privat arsimor është financiare. Megjithë shtimin e domosdoshëm të përqindjes së PBB për sektorin e arsimit dhe të një politike të mundshme agresive në thithjen e fondeve të huaja, nevojiten burime të tjera financiare për të kryer një hop në cilësinë e arritjeve të nxënësve dhe, për këtë shkak, tërheqja e biznesit kah tregu arsimor është një nevojë.

Politika inkurajuese ndaj institucioneve arsimore private, vendase ose të huaja, do të realizohet nëpërmjet mekanizmave të tilla si lehtësira fiskale dhe/ose mbulimin nga qeveria e një pjese të shpenzimeve rekurente operacionale. Këto mekanizma do të përdoren me përparësi për arsimin

profesional dhe post-secondary education, në mënyrë që ato t'u përshtaten më me fleksibilitet nevojave të tregut të punës; për arsimin e lartë, në mënyrë që të shkarkohet buxheti shtetëror nga mbishpenzimet për këtë nënsektor, dhe për arsimin parashkollor, në mënyrë që të sigurohet larmia e duhur e ofertave për të; si dhe për shkollat e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Favorizime ad hoc mund të bëhen sipas nevojave emergjente, si p.sh. për të siguruar aksesin ndaj shkollimit bazë ose të mesme të përgjithshme në zona të deprivuara ose për të siguruar normalitetin në zona me shkolla të mbipoplluara.

Zgjerimi i tregut të shërbimit arsimor privat përtej shkollimit privat si për trajnimin ose këshillimin e mësuesve dhe menaxherëve arsimorë, monitorimin dhe vlerësimin e anëve të ndryshme të sistemit arsimor, për asistencën ndaj nxënësve me nevoja të veçanta, etj., e kombinuar me një mbikqyrje të cilësisë së këtyre shërbimeve, do të sigurojë konkurrencën e mjaftueshme si parakusht të përmirësimit cilësor të këtyre shërbimeve.

Cilësia e pretenduar nga klientët e shkollimit privat do të garantohet përmes inspektimeve të tyre sistematike dhe transparencës së informacionit rreth arritjeve të nxënësve në këto shkolla.

Rreziku që konkurrenca e shkollave private ndaj atyre publike të përkeqësojë shërbimin arsimor publik do të parandalohet nëpërmjet menaxhimit dhe mësimdhënie-mësimnxënies mbi bazën e performancës (arritjeve të nxënësve) dhe transparencës së këtyre arritjeve ndaj opinionit publik dhe profesional.

A.2.2 Zhvillimi i profesionit të mësimdhënies

Parashikim më i mirë i kërkesës për mësues

Periodha e deritanishme e tranzicionit shqiptar është karakterizuar nga mungesa e dukshme e investimeve sistematike dhe të përqëndruara për trajnimin e mësuesve. Universitetet janë qenë përgjegjëse për trajnimin fillestar të mësuesve. Në vitet e fundit trajnimi i tyre gjatë punës është kryer në mënyrë të pakoordinuar. Agjenci të ndryshme joqeveritare vendase ose të huaja janë përfshirë herë pas here në trajnimin e mësuesve. Por mungesa e një metode tërësore dhe koherente ka ulur efektivitetin e këtyre trajnimeve.

Forcimi i Qendrës së Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin

Me ndihmën e Bankës Botërore u ngrit Qendra e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin. Ndër të tjera, ngritja e saj mori shkak edhe nga mungesa e standardeve të mësuesve, moduleve të tyre të trajnimit, vlerësimit të performancës, etj.

Pjesë e strategjisë së arsimit është edhe hartimi i udhëzimeve të qarta për rolet dhe përgjegjësitë e stafit të Qendrës e veçanërisht për lidhjet e saj me grupet e interesit në nivel rajonal dhe lokal.

Përmbajtja/procesi i kurrikulës për trajnimin e mësuesve, etj

Sigurimi i një baze të fortë në arsimimin e mësuesve arrihet nëpërmjet zhvillimit të kompetencave të detajuara për mësuesit e arsimit bazë dhe atij të mesëm. Ndihet nevoja për t'i pasqyruar këto kompetenca në programet universitare, të cilat duhet të udhëhiqen nga parimet e procesit të Bolonjës dhe të përfshirjes së praktikës profesionale si pjesë integrale e programit.

Skema motivuese të punësimit të bazuara në meritat

Tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë kërkon që QATK, në bashkëpunim me MASH, të studiojë skema të reja motivimi, të cilat bazohen në performancë/meritë dhe jo thjesht në stazhin e punës. Veprimi i parë që duhet të ndërmerret është respektimi i profesionit të mësuesit duke përshtatur pagat e tyre me ato të punonjësve civilë.

Shqyrtimi i modeleve të reja dhe alternative të trajnimit të mësuesve

Përveç skemës bazë të trajnimit, QTKA duhet të shqyrtojë modele alternative për sigurimin e trajnimit të mësuesve si: modele për trajnimin e mësuesve në klasa kolektive, modelin e trajnimit të mësuesve të klasave të caktuara, modelin e trajnimit të mësuesve të lëndëve të veçanta, modelin hibrid, mësimin frontal dhe mësimin në distancë. Për këtë qëllim do të zbatohen modelet e reja dhe alternative të trajnimit të mësuesve, të cilat zgjerojnë kompetencat e mësuesve për rritjen e efektivitetit të shkollës, afrimin e raportit mësues-nxënës me mesataren ndërkombëtare dhe rritjen e efikasitetit të sistemit arsimor.

Sigurimi i cilësisë/regjistrimi i mësuesve

Lind nevoja për të zhvilluar procesin e regjistrimit dhe akreditimit të mësuesve si dhe zbatimin e procedurave për monitorim të vazhdueshëm. Regjistrimi i mësuesve do të shërbejë si parakusht për të zënë një vend pune si mësues. Procedura e aplikimit për vend pune, e miratimit dhe e zgjidhjes së konflikteve duhet të hartohet dhe miratohet formalisht nga qeveria dhe MASH. Kjo duhet të realizohet së bashku me reformën e programeve të trajnimit të mësuesve.

Trainimi i mësuesve gjatë punës

Një nga çështjet më kritike, me të cilat përballet MASH, është trajnimi i një numri të madh mësuesish të pakualifikuar si dhe i mësuesve të tjerë për të zhvilluar kompeten-cat e tyre në përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve duhet të përputhet me nevojat e tyre. Për këtë arsye duhet të hartohet një program trajnimi i bazuar në parimin e kërkesës, në përputhje me nevojat, atributet e reja të mësuesve, njohuritë mbi lëndët e reja dhe modelet e reja të mësimin.

Sigurimi i cilësisë dhe efijencës së trajnimit të mësuesve gjatë punës kërkon përdorimin e metodave alternative. Për shembull, trajnimi mund të përfshijë trajnime intensive në bllok, mësimin në distancë, modelin e përzjerë që kombinon mësimin intensiv në fundjavë me mësimin në distancë. Siguruesit e trajnimit të mësuesve gjatë punës mund të vijnë nga universitetet, OJF-të, agjencitë ndërkombëtare apo shoqatat profesionale të mësuesve etj. Nëpërmjet trajnimeve profesionale, mësuesit marrin kreditet që u vlejné për kualifikimet formale dhe plotësimin e kriterëve për të fituar regjistrimin si mësues.

A.2.3 *Tekstet shkollorë*

Tekstet shkollorë, meqë kanë rëndësi të veçantë në zhvillimin e procesit të mësimdhënie-mësimnxënies, kompensojnë kompetencat e kufizuara të mësuesve dhe reflektojnë gjithashtu kuptimin e kufizuar të tyre për objektivat kurrikulare si pjesë të kurrikulave. Mësuesit trajtojnë më shumë përmbajtjen e teksteve shkollorë se sa objektivat e kurrikulës.

Përzgjedhje më e mirë e përmbajtjes dhe strukturës shpjeguese

Roli i teksteve shkollorë në procesin e mësimdhënie-mësimnxënies është i hapur për debat të mëtejshëm. Debatit duhet t'i nënshtrohen përmbajtja dhe struktura e teksteve. Është e nevojshme të rishikohen dhe të përshtaten proceset e hartimit të teksteve shkollorë dhe të sigurimit të cilësisë me ato të vendeve të BE dhe me vendet e tjera të zhvilluara. Metoda e deritanishme, ku në disa tekste mbizotërojnë pedagogët e universiteteve, nuk mund të jetë e efektshme, sikurse e tregon realiteti edhe në vende të zhvilluara. Mësuesit në shkolla duhet të inkurajohen që të përfshihen në hartimin dhe zhvillimin e teksteve shkollorë. Brezi i ri i teksteve shkollorë duhet të zbatojë metodat e mësimdhënie-mësimnxënies, të cilat karakterizohen nga situata të marra nga jeta, të jenë të orientuara nga zbatimet, si dhe të kenë në qendër nxënësin. Ato duhet të inkurajojnë punën në grup si dhe mendimin e pavarur, krijues dhe kritik. Është e nevojshme që autorët e mundshëm të trajnohen për hartimin e teksteve.

Koordinimi i kërkesës dhe ofertës për tekstet shkollore

Është e nevojshme që të zbatohet një metodë e planifikuar dhe e koordinuar për hartimin e teksteve shkollorë, veçanërisht gjatë rishikimit të kurrikulës së arsimit parauni-versitar. Kurrikula e re mund të ketë një kompozim të ndryshëm të përmbajtjes dhe të lëndëve. Numri i teksteve shkollorë dhe përmbajtja e shumë prej tyre pritet të ketë mjaft elementë të rinj. Baza e të dhënave EMIS do të ndihmojë në planifikimin e kërkesës dhe ofertës së titujve të ndryshëm të teksteve shkollorë.

Menaxhimi i kërkesës dhe ofertës për tekstet alternative

Me metodat e mësimnxënies që vënë në qendër nxënësin, tekstet alternative marrin rëndësi të madhe. Përzgjedhja e këtyre teksteve do të përfshijë të gjitha grupet e interesit, prindërit, shoqatat profesionale lëndore, qeverinë vendore etj., të cilët, nga ana e tyre, ushtrojnë kështu presion ndaj autorëve dhe shtëpive botuese. Bashkë me decentralizimin në arsim, personat që janë në kontakte të ngushta me lëndët dhe mësuesit, duhet të menaxhojnë dhe të monitorojnë kërkesën dhe ofertën për tekste.

Privatizimi

Për nivele të caktuara dhe lloje shkollash, zhvillimi dhe furnizimi me tekstet shkollorë duhet t'i kalojë sektorit privat. MASH do të ketë akoma përgjegjësi për sigurimin e cilësisë, duke bërë rekomandime për tekstet specifike të klasave të ndryshme. Procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollorë duhet të bëhet mbi bazën e konkurrencës dhe transparencës. MASH tashmë ka filluar punën në këtë drejtim dhe ka si synim privatizimin gradual të të gjithë aktivitetit të zhvillimit dhe botimit të teksteve shkollorë. MASH do të miratojë cilësinë e botimit dhe standardet e përmbajtjeve lëndore për klasa të ndryshme. Ajo do të luajë rolin e agentit të sigurimit të cilësisë dhe jo rolin e një shtëpie botuese.

Mbulimi i kostos

Është cilësuar progresive politika e dhënies së teksteve shkollore në përdorim falas për nxënësit e arsimit të detyruar. Megjithëse kjo politikë përbën një kosto të lartë për sektorin e arsimit, është e nevojshme që të gjenden mënyra dhe rrugë alternative për financimin e botimit të këtyre teksteve. MASH, me ndihmën e organizmave ndërkombëtare, do të shqyrtojë opsionet e mundshme. Kjo është e rëndësishme, pasi futja e metodave të reja mësimore kërkon një numër të madh burimesh për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

A.2.4 Burimet alternative të mësimdhënies

Burimi aktual kryesor i procesit mësimor në arsimin parauniversitar janë tekstet shkollorë. Kjo ka bërë që mësuesit të japin në mësim vetëm përmbajtjen e teksteve, pa përdorur burime të tjera alternative. Ndjehet nevoja për futjen graduale të teksteve shtesë dhe librave të tjerë të referencës, duke filluar në këtë mënyrë me krijimin e bibliotekave në klasa. Përveç kësaj, përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në programet e arsimit parauniversitar është shumë i kufizuar. Në shko-llat e mëdha ekziston mundësia e krijimit të bibliotekave me lidhje interneti.

Qendra e sapo krijuar e Trajnimit dhe Kualifikimit dhe Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve duhet të gjejnë mënyra për të zhvilluar dhe mbështetur me burime shtesë arsimin parauniversitar. Ato mund të punojnë dhe të mbështesin mësuesit në mënyrë që ata të zhvillojnë praktikat më të mira dhe për të shkëmbyer më pas përvojën me kolegët e tyre në të gjithë vendin. Ato duhet të angazhohen gjithashtu në kërkimin e vazhduar të informacionit të dobishëm për lëndë të ndryshme, si dhe të krijimit të CD-ve dhe materialeve të printuar, të cilat mund t'u shpërndahen shkollave që nuk kanë lidhje interneti. Ndërsa rolet e IKS dhe QTKA janë përcaktuar, do të jetë e nevojshme që ato të mendojnë për funksionet e tyre në një formë të re, në kërkim të vazhdueshëm të praktikave të reja si dhe të burimeve të reja të mësimdhënie-mësimnxënies.

A.2.5 Provimet dhe vlerësimet

Në kuadrin e reformës në arsim, krijimi i Qendrës Kombëtare Arsimore e Vlerësimit dhe Provimeve (QKAVP) dhe i Drejtorisë së Inspektimit në MASH shënon fillimin e dy reformave të rëndësishme institucionale. Ristrukturimi organizativ duhet të plotësohet me zhvillimin e burimeve njerëzore për të forcuar kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese. Për të rritur efektivitetin e QKAVP duhet të vihet në veprim një sistem i dyfishtë, i cili përfshin monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm e të jashtëm (Shihni sigurimin e cilësisë të pjesa e qeverisjes).

Forcimi i kapaciteteve

Kapaciteti aktual i QKAVP duket se konsiston vetëm në njohuri statistike, ndaj ai duhet të zgjerohet duke përfshirë ekspertë në fushën e arsimit, të cilët mund të hartojnë tregues rigorozë për të matur rezultatet e të nxënësve. Kjo qendër ka nevojë për pajisje bashkëkohore për të përmbushur detyrën e vet dhe për të ndërmarrë misionin e përdorimit të treguesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të rezultateve të procesit mësimor.

Monitorimi i cilësisë dhe përdorimi i treguesve ndërkombëtarë

Nisur nga synimi i përgjithshëm politik i sigurimit të kapaciteteve të afta për ta integruar vendin në BE, është tepër e nevojshme që të zhvillohen treguesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë arsimorë si dhe sistemet e monitorimit të tyre. QKAVP ka përfituar disa trajnime të financuara nga projekti i BB në arsim, por ka ende nevojë për krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve. Kështu, ende nuk është arritur të krijohet një sistem korigjimi dhe klasifikimi i barazvlefshëm për të krahasuar rezultatet me vende të ndryshme të rajonit.

Zhvillimi dhe menaxhimi i provimeve kombëtare

Aktualisht publiku ka pak besim në sistemin aktual të provimeve, prandaj QKAVP ka për detyrë që të kthejë integritetin dhe besimin e publikut në sistemet e provimeve. Kjo qendër duhet të zhvillojë një sistem transparent, të sigurtë dhe që të mos lejojë daljen e çfarëdolloj informacioni që lidhet me provimet. Procesi i zhvillimit dhe korigjimit të provimeve duhet të rishikohet në mënyrë të tillë që të eliminohen mundësitë për kopjim. Mësuesit nuk duhet të lejohen të mbikëqyrin nxënësin e tyre; fletët e provimit duhet të jenë të koduara në mënyrë të çrregullt dhe jo me etiketa të lexueshme. Të gjitha konfliktet e interesave dhe situatat komprometuese duhet të eliminohen nga sistemi i menaxhimit të provimit.

QKAVP do të kryejë kërkime dhe do të konsultohet me grupe të ndryshme interesi për të organizuar dhe zhvilluar një provim të vetëm në klasën e 12. Ky provim duhet të shërbejë si tregues i njohurive të fituara nga nxënësit dhe si një kriter bazë për hyrje në universitet. Metoda e propozuar e gruplëndëve në kurrikulën e arsimit të mesëm do të lejojë artikulumin në programet universitare. Si rezultat, niveli i arritjeve në provimin e maturës do të përdoret nga universitetet si kriter edhe për pranimet në universitete.

A3 FINANCIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Duke filluar nga viti 1989, shpenzimet publike për arsimin, si pjesë e PPB, kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme, nga 4% në vitin 1989, në 3% në vitet 2000 e 2001, dhe në 2,9% në vitin 2003. Këta tregues janë më të ulët se mesatarja e vendeve të tjera të rajonit. Buxheti i shtetit për arsimin në vitin 2003 ishte vetëm 10,3% e shpenzimeve të përgjithshme publike. Ky tregues, krahasuar me 11,4% për vitin 1995, dhe 11,5% për vitin 1996 nuk dëshmon për rritje.

Aspiratat ekonomike dhe sociale, në progres të vazhdueshëm, diktojnë ndryshime të mëdha në sistemin arsimor dhe, nëse ky sektor nuk financohet në mënyrë të mjaftue-shme, shërbimi arsimor rrezikon jo vetëm të përkeqësohet, por edhe deri mund të mos sigurohet.

Nga fundi i viteve 90-të, kërkesa për shpenzime kapitale është rritur ndjeshëm për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së vazhdueshme të objekteve shkollore dhe dëmtimit të tyre gjatë periudhës së tranzicionit dhe në krizën e vitit 1997. MASH duhet të kërkojë mjete alternative që mund të përballohen nga burimet kombëtare.

A 3.1 Instrumentat dhe proceset për transferimin e fondeve

Modeli "për nxënës" i financimit

Cilido qoftë procesi, duket se sistemi i financimit në arsim nuk i përgjigjet me efektivitet plotësimin të nevojave në ndryshim. Kështu psh., ndërkohë që gama e shërbimeve dhe shpërndarja e burimeve të financimit në sektorin e arsimit parauniversitar kanë ndryshuar, shpenzimet e përgjithshme tregojnë se sistemi aktual i financimit nuk po u përgjigjet me të njejtin ritëm zhvillimeve progresive të këtij sektori. Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm në rritje i nxënësve, që ndjekin shkollën, mund të krijojë probleme në sistemin e financimit në nivel rajonal. Për të kapërcyer këto dukuri, pra, për t'iu përgjigjur kërkesave në ndryshim si dhe për të siguruar barazinë për nxënësit dhe rajonet, modeli i financimit "për nxënës" (per capita), që lidhet direkt me shkollat, mund të jetë një alternativë e pranueshme për këtë qëllim. Ky model bazohet në numrin aktual të nxënësve, si dhe gjeografinë e shtrirjes së shërbimeve të nevojshme, në numrin e mësuesve si dhe në stafin mbështetës dhe jo në sasinë e parave të paracaktuara sipas praktikave pragmatike e arkaike të përdorura deri më sot.

Financimi i qeverisë vendore

Në skemën menaxhuese aktuale të shërbimit arsimor, mirëmbajtja e shkollave është përgjegjësi e pushtetit vendor dhe realizohet nëpërmjet financimit nga granti i pakushtëzuar (i përfituar nga buxheti i shtetit) dhe kontributi i qeverisjes vendore (i përfituar nga taksat lokale etj). Në praktikën e ndjekur gjer më sot, MASH-it nuk i raportohet për sasinë e financimit që i akordohet sektorit të arsimit në përgjithësi dhe nënsektorëve të tjerë nga qeveria vendore. Kësisoj MASH nuk merr informacionin e mjaftueshëm për sasinë e disbursimeve të fondeve nga ana e qeverisë vendore (shpenzimet që kryhen për mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore dhe anekseve ndihmëse), pra as për financimin e shërbimit arsimor në tërësi. Mungesa e një informacioni të tillë e pengon seriozisht MASH për hartimin e një planifikimi financiar të besueshëm dhe efektiv.

Menaxhimi i shpenzimeve korrente nga MASH

MASH menaxhon disbursimin e të gjitha shpenzimeve korrente, d.m.th. shpenzimeve të lidhura me botimin e teksteve shkollore, me bursat e nxënësve, me materialet didak-tike si dhe me transportin e mësuesve dhe nxënësve. Në dritën e kosto-efektivitetit, mbajtja e disa shërbimeve në nivel qendror përbën avantazh, ndërsa transporti i nxënësve dhe mësuesve si dhe bursat mund të realizohen më mirë nga pushteti lokal. Realizimi i decentralizimit në sistemin arsimor do të rriste efikasitetin (duke ulur shpenzimet) për këtë shërbim. Megjithatë, planifikimi buxhetor i detajuar është i nevojshëm për të rritur përgjegjshmërinë ndaj këtyre fondeve në të dyja nivelet, qendror dhe rajonal. Të dyja palët duhet të jenë të afta të ndajnë kostot sipas zërave.

Përgjegjshmëria dhe transparenca

Procedura e transferimit të të gjitha fondeve nga niveli qendror në atë rajonal/lokal, si dhe kontributet e qeverisë vendore duhet të jenë sa më transparente. Përfshirja e zërave të veçantë në buxhet për të gjitha veprimtaritë kryesore, nëpërmjet financimit qendror dhe rajonal/lokal, do të qartësojë një pjesë të konfuzionit ekzistues. MASH ka identifi-kuar shtatë programe, që nuk figurojnë në nivelet e qeverisjes vendore. Prania e zërave të tillë në këto nivele do të sigurojë realizimin e disbursimeve sipas planifikimit dhe kohës së parashikuar. Por, ajo që është më e rëndësishme, praktika e propozuar do të ndihmojë planifikuesit financiarë për evidentimin e mungesave dhe shpenzimeve konkrete në nivelet e ndryshme të sistemit.

Kapaciteti i planifikimit të buxhetit

Modeli aktual i ofertës së shërbimeve arsimore reflektohet në sistemin financues. Një nga kërkesat kryesore të reformimit në skemën e menaxhimit dhe të financimit të shër-bimit arsimor është kalimi në modelin e bazuar në kërkesën dhe performancën. Që të arrihet kjo, është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet në korelacion me nivelet e ndryshme të sistemit financiar në mënyrë që të përfshihen aktivisht në hartimin e planit të detajuar buxhetor dhe në zbatimin e këtij plani.

A 3.2 Rritja e efikasitetit në financimin e nënsektorit

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Informacioni i lidhur me kontributin e qeverisë vendore për sektorin e arsimit duhet t'i vihet në dispozicion MASH, kur kjo e fundit planifikon

buxhetin. Ky lloj shkëmbimi i informacionit financiar midis MASH, MF, qeverisë vendore dhe shkollave ka munguar. Sistemi EMIS, i planifikuar për MASH, duhet të organizohet në formë të tillë që të mbledhë dhe të menaxhojë këtë lloj informacioni. Një grup ekspertësh financiarë duhet të angazhohen në përcaktimin e tipit të të dhënave, nivelin e mbledhjes, tipin dhe shkallën e analizës së tyre, gjë që do të forcojë kapacitetet e MASH në planifikimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të veta.

Mbledhja e të ardhurave për shkollat

Duhet të rishikohen praktikat aktuale të transferimit të të ardhurave në një llogari të vetme bankare, duke vendosur taksa për sasinë e mbledhur të fondeve, si dhe vendimet lidhur me shpenzimet e bëra nga bashkitë dhe komunat. Shkollat dhe komunitetet duhet të kenë kontroll të plotë të të ardhurave. Përqindjet aktuale që i kalojnë shtetit nga këto fonde duhet të rishikohen, me tendencë minimizimin e tyre, në mënyrë që të inkurajohen më shumë prindërit dhe komuniteti. Shkolla duhet lejuar që të rrisë pavarësinë në përdorimin e të ardhurave të krijuara nga paisjet e veta dhe mjediset si dhe nga punonjësit që angazhohen jashtë orarit të punës.

Përrjashtimi nga taksat i investimeve në arsim

Duke parë tkurrjen e financimit publik në arsim vitet e fundit, shkollat duhet të inkurajohen që të gjejnë burime alternative financimi. Për të inkurajuar rritjen e kontributit bamirës të publikut, të gjitha financimet alternative duhet të përjashtohen nga taksat, në mënyrë që çdo qindarkë e dhuruar të përdoret për përmirësimin dhe mbështetjen e cilësisë në arsim. Gjithashtu, OJF-të, mësuesit dhe nxënësit, të cilët blejnë materiale mësimore si kompjutera etj., duhet të përjashtohen nga taksat. Është e nevojshme që të thjeshtohen rregullat për përjashtime të tilla, në mënyrë që njerëzit të financojnë më shumë në këtë fushë.

Rialokimi i fondeve

Arsimi bazë është nënsektori prioritar i arsimit. Prandaj MASH duhet të rishikojë shpenzimet në arsimin e lartë sipas modelit "përfituesi i shërbimit paguan koston" me qëllim që të favorizojë financimin e niveleve të tjera të arsimit. Fondet shtesë të përfituara nga burimet e brendshme e të jashtme duhet të përdoren me përparësi nga arsimi parauniversitar.

A 3.3 Sistemet e ekspertizës dhe mbështetjes së reformës së propozuar

Ekziston rreziku që disa komuna ose bashki mund të mos jenë të afta që të menaxhojnë shkollat me kosto-efektivitet. Kjo situatë mund të parandalohet duke krijuar partne-ritete midis këtyre të fundit me ato fqinje. Veç kësaj, ekspertët e institucioneve arsimore të specializuara dhe/ose ata të drejtorive arsimore rajonale, mund t'u atashohen shkollave që kanë nevojë për ndihmë. Ky rrezik është i pranishëm edhe në nivel shkolle dhe mund të parandalohet duke i menaxhuar shkollat e vogla në grupe me buxhet të përbashkët.

A.4 KRIJIMI I KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE - NDRYSHIMI KONCEPTUAL

Kalimi nga një sistem i centralizuar dhe i orientuar sipas ofertës në një sistem të bazuar në kërkesa (sipas vizionit të autoriteteve lokale dhe konsumatorit) dhe përgjegjshmëria në rritje kërkojnë një ndryshim thelbësor konceptual, i cili, nga ana e vet, do të japë impaktin e tij në çështjet operative. Propozimet kryesore rreth sistemeve të përgjegjshmërisë disanivelëshe dhe të orientuar nga kërkesa janë shumë komplekse, po të kemi parasysh historinë e vendeve ku, në të kaluarën, ka sunduar ideologjia komuniste e bazuar në modelin e ofertës. Marrëdhëniet midis shtetit dhe qeverisë lokale, shtetit dhe individit, shtetit dhe sektorit privat etj., duhet t'i nënshtrohen një transformimi të madh. Për këtë arsye, në këtë kapitull shtjellohen disa ndryshime të rëndësishme dhe të nevojshme në sektorin e arsimit në kuadër të reformës arsimore.

Duke pasur parasysh rritjen e kostos në buxhetin e sektorit publik, të diktuar nga kërkesa për një sistemi arsimor cilësor, është e nevojshme të përzgjidhen sisteme e modele të reja dhe efikase. Nga ky këndvështrim duhet të zbatohet një metodë e bazuar në kërkesën, e cila do të mbështetet nga një sistem rigoroz monitorimi dhe vlerësimi, i krijuar në kuadrin e projektit EMIS. Më poshtë jepen disa konsiderata të veçanta, si aspekte të rëndësishme të strategjisë së arsimit kombëtar.

A 4.1 Arsimi si shërbim ndërsektoral

Sistemi arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, i cili do të pajisë qytetarët e ardhshëm shqiptarë me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Ai synon plotësimin e nevojave kombëtare të tregut të punës dhe aspiratat social-kulturore të popullit.

Prandaj, veprimtari të tilla si, p.sh., hartimi i kornizës kombëtare kurrikulare duhet të përfshijnë dialogun dhe inputin ndërsektoral, në mënyrë që korniza e propozuar të reflektojë nevojat e të gjithë sektorëve që mund të jenë të panjohura nga ata që deri më sot janë të përfshirë vetëm në sektorin e arsimit. E parë nga një këndvështrim tjetër, nevoja për dialog ndërsektoral dhe për harmonizim të mbështetjes mund të reflektohet në një sërë veprimtarish të ngjashme, të financuara dhe mbështetura nga ministri të linjave të ndryshme. Kështu, p.sh., programet që lidhen me “fëmijët e punësuar”, programet “ushqim për edukim”, subvencionet për “familjet në nevojë”, etj., aktualisht menaxhohen dhe drejtohen nga disa ministri të ndryshme. Për të rritur impaktin e këtyre programeve, kërkohet koordinimi i veprimeve ndërmjet ministrive që i menaxhojnë këto programe.

A 4.2 Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave

Duke marrë në konsideratë tendencat e larta të migrimit, natyrshëm lind nevoja për të krijuar një bazë të besueshme të dhënash të hartës së shkollave. Me anë të saj do të realizohet një planifikim më i besueshëm dhe afatgjatë, që do të sjellë një përdorim më eficient të burimeve të kufizuara, në dispozicion të sektorit të arsimit parauniversitar. Duhet të racionalizohen shkollat që janë jo ekonomike në menaxhim dhe të paqëndrueshme në kuadrin e zhvillimit institucional. Nga ana tjetër, duhen gjetur dhe eksperimentuar modele alternative për të siguruar shërbimin arsimor në zonat me dendësi të ulët popullore. Ndërsa kërkesa e përgjithshme për vende të reja mund të mos rritet, rishpërndarja e shkaktuar nga migrimi i brendshëm do të krijojë nevojën për klasa të reja.

MASH duhet të sigurojë në të njëjtën kohë barazinë e shanseve dhe efektivitetin.

Racionalizimi mund të paraqesë sfida për sistemet me bazë lokale, ku shkollat janë të veçuara nga njera-tjetra për shkak të kufijve administrativë midis zonave dhe rretheve, por numri i vogël i nxënësve po i bën këto shkolla të papërdorshme.

A 4.3 Inspektimi dhe ndihma

Roli i inspektorëve në MASH shihet si një mekanizëm ndëshkues dhe kontrollues. Kjo duhet të ndryshojë nëse ne dëshirojmë që profesionistët në arsim të jenë novatorë dhe të përfshihen në procesin e vetzhvillimit. Një dështim në sistem, është përgjegjësi e barabartë për të gjithë ata që janë të përfshirë në detyra arsimore në nivele të ndryshme të tij. Opsioni më i mirë do të ishte të qenit më aktiv dhe të qenit përherë i angazhuar në sigurimin e mbështetjes. Ky ndryshim konceptual ka rëndësi për suksesin e procesit të “vetëraportimit”, i futur si pjesë e sigurimit të cilësisë dhe monitorimit. Që individët të raportojnë me ndershmëri,

ata duhet të kenë besim te sistemi. Nëse jo, problemet që lindin nga të dhënat dhe rezultati jo i besueshëm do të vazhdojnë, prandaj çdo planifikim që merr për bazë këto të dhëna s' do të ketë vlera.

A 4.4 Profesionalizimi i mësimdhënies

Ngarkesa aktuale mësimore për mësuesit kërkon një vëmendje të re lidhur me statusin e profesionit të mësuesit. Ndryshe nga vendet e BE-së, mësimdhënia në Shqipëri nuk konsiderohet si një profesion me kohë të plotë. Duke patur parasysh se një nga objektivat e reformës është përafrimi i kapaciteteve dhe i sistemit arsimor me ato të vendeve të BE, mësimdhënia në Shqipëri duhet të shihet si një shërbim publik. Si rrjedhojë, mësuesit duhet të punojnë 30-40 orë në javë. Një trajtim i tillë do të rrisë angazhimin nga ana e mësuesve, si dhe do të justifikojë shtimin e rrogës bazuar në rritjen e orëve mësimore.

Efikasiteti dhe eficaenca mund të rritet edhe nëpërmjet futjes së kompetencave ndërdisiplinore për mësuesit e arsimit bazë dhe të paktën në deri në dy disiplina mësimore për mësuesit e arsimit të mesëm. Këto veprime mund të sjellin ulje në numrin total të mësuesve, por do të ndihmojnë në përmirësimin e raportit mësues-nxënës dhe do ta bëjnë sistemin arsimor shqiptar të krahasueshëm me atë të vendeve të rajonit.

Shoqatat profesionale të mësuesve duhet të zhvillohen dhe mbështeten si një burim i rëndësishëm për përmirësimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies, të novacio-neve kurrikulare dhe eksperimentimit të ideve novatore.

A 4.5 Lëndët me zgjedhje dhe specialitetet

Arsimi për të gjithë nuk do të thotë se çdo njeri studion të njëjtat lëndë në të njëjtën mënyrë. Sistemi arsimor duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë, që t'i pajisë nxënësit në nivelet e ulta me njohuri bazë si shkrim e këndim, matematikë dhe aftësi bazë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Ndërsa nxënësit kalojnë në nivele më të larta, kurrikula duhet të jetë më fleksibël dhe t'u ofrojë atyre bllok lëndësh, si lëndë me zgjedhje (shkencat shoqërore, biznes dhe ekonomik, inxhinieri, shkencat mjekësore). Kjo mënyrë rrit shkallën e specializimit, bazuar në zgjedhjen e lëndëve, dhe njëkohësisht redukton nevojën për t'u ofruar nxënësve të gjitha lëndët. Nëpërmjet zgjedhjes kurrikulare lidhur me numrin dhe llojet e bllok-lëndëve, shkolla fiton autonomi për të vendosur se çfarë kombinim lëndësh do t'u ofrohet nxënësve në shkollën e mesme.

Përveç kësaj, po futen shumë lëndë të reja si arsimi për biznesin, multimedia dhe komunikimi etj. Kjo kërkon që hartuesit e kurrikulave të jenë të guximshëm dhe të rishikojnë lëndët që mund t'u ofrohen nxënësve dhe/ose

zgjedhjet e lëndëve të integruara, për të formuar lëndë më gjithpërfshirëse. Integrimi i lëndëve do të përmirësojë rezultatet e nxënies dhe do të reduktojë kostot, në mënyrë të tillë që të mos jetë më nevoja e pasjes së një teksti mësimor për secilën lëndë. Futja e specializimit në klasat e shkollës së mesme mund të reduktojë shpenzimet e tepërta të shkaktuar nga detyrimi i nxënësve për të studiuar të gjitha lëndët. Ndryshimet e mësipërme në kurrikul do të ndikojnë në numrin e mësuesve, teksteve shkollore dhe klasave. Pra futja e lëndëve të reja dhe/ose bashkimi i atyre të vjetra, si lëndë të integruara, mund të hasë mjaft rezistencë, meqë shumë mësues lëndësh mund të dalin të papunë. Hartuesit e kurrikulës duhet të konsultojnë literaturën kompetente, në mënyrë që t'i shpjegojnë publikut përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i metodës së re të zhvillimit të kurrikulës.

A 4.6 Zhvillimi i politikave i bazuar në kërkim dhe i orientuar nga të dhënat

MASH ka krijuar sektorin SAPP, për tu angazhuar në punë analitike të mirëfilltë. Është e nevojshme që të rritet numri i stafit në këtë sektor dhe të sigurohet zhvillimi i konsiderueshëm i kapaciteteve të tyre për të realizuar me efikasitet detyrat dhe përgjegjësitë e veta. MASH ka iniciuar zhvillimin e sistemit EMIS që të mbledhë të dhënat në nivele të ndryshme në sistemin e arsimit parauniversitar. Për t'i bërë sistemin EMIS dhe sektorin SAPP sa më efektivë, duhet të kultivohet kultura e përmirësimit të vazhdueshëm - hartimi i vazhdueshëm i kurrikulave, përmirësimi i vazhdueshëm i shkollave dhe zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore. Të gjitha vendimet për politikën në lidhje me sektorin e arsimit në përgjithësi dhe arsimin parauniversitar në veçanti duhet të bazohen në të dhëna. Në rast se mungojnë të dhënat, MASH duhet të autorizojë kryerjen e një kërkimi të veçantë në mënyrë që të arrihet një vlerësim më i saktë i problemeve shqetësuese.

A.5 ZHVILLIMI I ARSIMIT PROFESIONAL

A 5.1 Panoramë e përgjithshme e Arsimit Profesional

Në kuadrin e arsimit, si një nga prioritetet më të rëndësishme të Programit të Qeverisë për vitet e ardhshme, një vend të veçantë zë zhvillimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i Arsimit Profesional (AP), i cili synon, mes të tjerash, inkurajimin e përvetësimit të njohurive të reja, afrimin e shkollës me botën e punës, luftën kundër përjashtimit të të rinjve nga pjesëmarrja në jetën ekonomike e sociale të vendit, mësimin gjatë gjithë jetës si dhe krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë.

Në përputhje me ligjin Nr. 8872, dt. 29.03.2002, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", ndjekja e AP bëhet pas përfundimit të arsimit të detyruar tetëvjeçar dhe përbëhet nga këto tipa e nivele:

- a) Arsimi profesional, me karakter të theksuar praktik, që pajis nxënësit me kompetencat e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale, në një specialitet të dhënë. Është strukturuar në dy nivele: *Niveli i parë*, me kohëzgjatje 3 vjeçare (ekuivalente me kategorinë 3C të ISCED-*International Standard Classification of Education*), nuk përfundon me maturë, por jep çertifikatë të aftësisë profesionale si dhe lejon kalimin në nivelin e dytë të arsimit profesional, në të njëjtin specialitet. *Niveli i dytë*, me kohëzgjatje 2 vjeçare, pas nivelit të parë, (ekuivalente me kategorinë ISCED 3A), përfundon me maturë si dhe me çertifikatë të aftësisë profesionale. Lejon kalimin në Universitet, në të gjitha drejtimet.
- b) Arsimi i mesëm teknik (ekuivalente me kategorinë ISCED 3A), i pajis nxënësit me kulturë të përgjithshme dhe teknike/manaxheriale, për të organizuar e drejtuar veprimtari profesionale në një drejtim apo specialitet të dhënë. Ka një kohëzgjatje 5 vjeçare (pas arsimit të detyruar) dhe jep maturën si dhe çertifikatën e aftësisë tekniko-profesionale. Lejon kalimin në Universitet, në të gjitha drejtimet.

Aktualisht në shkallë vendi funksionojnë 40 shkolla të mirëfillta të arsimit teknik e profesional, të shpërndara në 22 rrethe, ku nxënësit përgatiten në rreth 35 specialitete kryesore. Nga këto, në zonat rurale funksionojnë 3 shkolla profesionale, me drejtim kryesor bujqësi-agrobiznes. Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat tekniko-profesionale publike, duke përfshirë edhe ato artistike, pedagogjike, sportive dhe të gjuhëve të huaja (të emërtuara social-kulturore), përbën rreth 20% të nxënësve që vijojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kjo shifër është mjaft e ulët, duke patur parasysh që në vendet e OECD, ky tregues është rreth 50% dhe në disa vende të zhvilluara perëndimore, akoma më i lartë.

A 5.2 Karakteristikat kryesore dhe problematika e AP

Megjithë ndërhyrjet reformuese të ndërmarra vitet e fundit, si dhe mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, AP në Shqipëri, pavarësisht shënjave pozitive për një rigjenerim të tij, vazhdon të jetë me reputacion të ulët dhe të mos luajë rolin e duhur në zhvillimet aktuale dhe të pritshme.

Ai vazhdon të ketë karakteristikat dhe problematikën e mëposhtëme:

- AP konsiderohet si "sistem me bazë shkollën", ku përgatitja teorike dhe ajo praktike e nxënësve, realizohet kryesisht në mjediset e shkollës profesionale dhe, kur është e mundur, edhe në ndërmarrje.

- Përmbajtja e kualifikimeve profesionale është e ndryshme në vartësi të drejttimeve dhe niveleve, por në përgjithësi, është e strukturuar si më poshtë: (a) për nivelin 3 vjeçar, 34% kulturë e përgjithshme, 33% teori profesionale dhe 33% praktikë profesionale, dhe (b) për nivelin 5 vjeçar, 40% kulturë e përgjithshme, 35% teori profesionale dhe 25% praktikë profesionale.
- Pranimi në shkollat profesionale publike, në përgjithësi është i hapur për të gjithë nxënësit që përfundojnë arsimin e detyruar, ndërsa në raste të veçanta, ku kërkesat janë më të larta se sa mundësitë, bëhet me konkurs, në përputhje me udhëzimet e MASH. Megjithatë niveli i hyrjes së nxënësve në AP është më i ulët se sa në gjimnaze dhe në një masë të dukshme ndikon në cilësinë e ulët në përfundim të shkollimit.
- Financimi i sistemit të AP publik bëhet nga buxheti i shtetit për arsimin, buxheti i pushtetit vendor, projektet e donatorëve, sponsorizimet, të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike të vetë shkollave dhe burime të tjera të lejuara nga ligji. Megjithatë ky financim është ende i pamjaftueshëm, krahasuar me nevojat e sektorit.
- Aktualisht, në sistemin e AP nuk është i parashikuar formalisht funksioni i orientimit profesional dhe këshillimit për karrierën.
- Mungon sistemi i trajnimit paraprak (pre-service) për mësuesit dhe instruktorët e lëndëve e praktikave profesionale. Po kështu, nuk ka një program kombëtar të veçantë për trajnimin e vazhdueshëm (in-service) të kësaj kategorie mësimdhënë-sish dhe veprimtaritë trajnuese ofrohen në mënyrë sporadike nga projektet e donatorëve, DAR dhe ish Instituti i Studimeve Pedagogjike. E njëjta situatë është dhe përsa i përket trajnimit të drejtuesve të shkollave profesionale.
- Ndërhyrjet kryesore janë bërë kryesisht në nivelin shkollor dhe ndryshimet në nivelin e sistemit kanë qenë të papërfillshme.
- Ka pabarazi të mëdha midis shkollave profesionale nga pikëpamja e burimeve njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës. Në përgjithësi, infrastruktura materiale e pjesës më të madhe të shkollave profesionale është mjaft e dobët.
- Megjithë hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për AFP (Mars 2002), për shkak të ritmeve të ulëta të hartimit të akteve nënligjore dhe të mosfunksionimit si duhet të mekanizmave të parashikuar në ligj, lidhjet e AP me tregun e punës dhe me partnerët socialë vazhdojnë të jenë të dobëta.
- Kurrikuli i AP, pavarësisht nismave për modularizim dhe decentralizim, në përgjithësi, vazhdon të mbetet tradicional dhe larg realitetit profesional. Ka mungesa të ndjeshme të teksteve dhe materialeve të tjera në mbështetje të mësimdhënies.

- Mësimdhënia mbetet tradicionale edhe për shkak të mungesave në kualifikimin e personelit mësimdhënës.
- Procesi i vlerësimit përfundimtar të nxënësve bëhet nga vetë shkollat. Në shumicën e rasteve ai kryhet me mjaft mungesa dhe me fiktivitet të theksuar, sidomos për praktikat profesionale. Kjo bën që certifikatat që ofrojnë shumica e shkollave profesionale të mos kenë reputacionin e duhur.

A 5.3 Objektivat strategjike të Arsimit Profesional

Arsimi Profesional gjatë dekadës së ardhshme duhet të orientohet drejt një *reformë sistemike*, e cila i përgjigjet nevojës për ndryshimin e AP në një sistem të aftë për t'u përshtatur me pasigurinë dhe paqëndrueshmërinë e punësimit, të varur nga tregjet e punës në ndryshim të vazhdueshëm. Kjo reformë shkon përtej ndryshimeve thjesht institucionale, duke kërkuar edhe ndryshime thelbësore në vizionin, qëndrimet dhe sjelljen e të gjithë të angazhuarve.

Prirjet e zhvillimit të sistemit të AP shqiptar duhet të orientohen nga objektiva që çojnë në krijimin e një AP *tërheqës*, që ofron akses për të gjithë të interesuarit dhe mundësi më të mëdha punësimi dhe kalimi në nivelet e tjera më të larta (psh. terciar), të jetë *reagues i menjëhershëm* ndaj zhvillimeve dhe nevojave të tregut të punës në nivel rajonal/kombëtar dhe sidomos në nivel lokal, të jetë *eficient*, të mbështetet në një *model partneriteti* që angazhon në veprimtaritë e tij të gjitha palët përkatëse (qeveria, partnerët socialë, komuniteti, etj.). Ai duhet të bartë konceptin e *të nxënësve gjatë gjithë jetës*, pra të krijojë mundësinë e akumulimit, transferimit dhe njohjes së krediteve për arritjet e fituara me forma dhe mënyra të ndryshme, si dhe të *përshtatet* gradualisht në përputhje me nivelet e kualifikimit të pranuar nga Bashkimi Europian.

Në vija të përgjithshme, zhvillimi i AP, si pjesë integrale e Arsimit Parauniversitar, do të kryhet në përputhje me objektivat e mëposhtëme, të cilat marrin në konsideratë edhe zhvillimet e kohëve të fundit, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë, si dhe iu referohen dokumenteve të rëndësishme të BE-së që lidhen me veçoritë e sektorit të AP.

1. Nga pikëpamja e strukturës së sistemit të AP:

Rritja e fleksibilitetit të ofertës, mundësive të pranimit, përparimit dhe mobilitetit vertikal e horizontal (midis niveleve dhe drejtimeve) në AP, nëpërmjet:

- a) Krijimit të një *Kuadri Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale (KKKP)*, i cili do të përmbajë:

- *Nivelet e kualifikimeve profesionale dhe treguesit (përshkruesit) e këtyre niveleve nga pikëpamja e standardeve të profesioneve.*
 - *Drejtimet (profilet, specialitetet) e kualifikimeve profesionale dhe përshkrimet (standartet) respektive për çdo nivel të tyre.*
 - *Kriteret e vlerësimit (testimit) kundrejt standardeve që përmban KKKP.*
 - *Përshkrimin e Certifikatave për kualifikimet profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*
- b) *Përshtatjes së strukturës së sistemit të AP duke u bazuar në KKKP dhe duke marrë parasysh nivelet rekomanduese të Kuadrit Europian të Kualifikimeve:*
- *niveli hyrës në punësim, që ofron çertifikatë të përgatitjes bazë profesionale;*
 - *niveli i punëtorit të kualifikuar, që ofron çertifikatë të përgatitjes profesionale;*
 - *niveli teknik/menaxherial që ofron diplomën e maturës teknike.*
- c) *Krijimit të një cikli të veçantë për të plotësuar kulturën e përgjithshme të nxënësve që mbarojnë nivelin e punëtorit të kualifikuar për të ofruar diplomën e maturës teknike.*
- d) *Krijimit të një cikli post-sekondar me orientim profesional për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe kërkojnë të marrin një kualifikim profesional.*

Nga pikëpamja sasimore, treguesi kryesor i zhvillimeve të pritëshme në këtë periudhë do të jetë *dyfishimi i tërheqjes së nxënësve në shkollat teknike-profesionale dhe ato social-kulturore*, nga aktualisht 20% të arsimit të mesëm në 40%.

2. Nga pikëpamja e Kurrikulit të AP:

Modernizimi i modelit kurrikular për ta afruar me kërkesat e botës së punës dhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit, nëpërmjet:

- a) *Institucionalizimit të një strukture Kurrikuli të AFP dy shkallëshe (të decentralizuar), me skeletkurrikula (si standard kombëtar i kualifikimit profesional përkatës) të hartuara në nivel qendror dhe kurrikula në nivel shkolle, të bazuara në skeletkurrikulat përkatëse, kërkesat reale të tregut lokal të punës dhe mundësitë konkrete të shkollës.*
- b) *Modularizimit gradual të Kurrikulit të AP për të lehtësuar integrimin e kompetencave e standardeve të profesionit dhe për të mundësuar akumulimin, transferimin dhe njohjen e krediteve të fituara nga nxënësi.*

- c) *Institucionalizimit të një metodologjie të hartimit të Kurrikulave të AP që bazohet në analizën e profesioneve, që e konsideron hartimin e kurrikulit si një proces të vazhdueshëm e shumëshkallësh dhe angazhon të gjithë të interesuarit në këtë proces.*
- d) *Mbështetjes së kurrikulit të AP me "tekste integrale" që përdoren për një kohë relativisht të gjatë, nga një numër i madh nxënësish jo vetëm të një niveli apo drejtimi profesional, duke ulur ndjeshëm kostot e prodhimit të tyre.*

3. Nga pikëpamja institucionale:

Zhvillimi i mekanizmave institucionalë për kryerjen e funksioneve të reja dhe mbështetjen e funksioneve aktuale në AP, nëpërmjet:

- a) *Fuqizimit të rolit të Këshillit Kombëtar të AFP (komisioneve të specializuara dhe sekretariatit të tij) si një organizëm këshillimor tripalësh (qeveri, punëdhënës, punëmarrës), në mbështetje të zhvillimit të politikave reformuese të AFP.*
- b) *Krijimit të Agjencisë Kombëtare të AFP për të kryer funksionet e mëposhtëme ndërsektoriale, që aktualisht nuk arrijnë të përmbushen si duhet ose nuk përmbushen fare nga dikasteret dhe institucionet e AFP:*
- *Hartimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i Listës Kombëtare të Profesioneve dhe përshkrimeve përkatëse.*
 - *Hartimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i KKKP (me përshkrimin e standardeve për nivelet dhe drejtimet, kritereve të vlerësimit dhe certifikimit).*
 - *Hartimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale.*
 - *Hartimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i Manualit të Akreditimit të institucioneve që ofrojnë kualifikime profesionale.*
 - *Kryerja e analizave të nevojave për kualifikime profesionale në nivel kombëtar.*
 - *Ndërtimi dhe rifreskimi i Bankës së të Dhënave në lidhje me KKKP, skelet-kurrikulat, akreditimin, nevojat për kualifikime profesionale etj, që lidhen me AFP.*
- c) *Fuqizimit të Bordeve të shkollave profesionale me partnerë socialë (punëdhënës e punëmarrës).*
- d) *Krijimit të Departamenteve (mbi baza profesionale) në shkollat profesionale, si njësi të zhvillimit dhe përshtatjes së kurrikulave në nivel shkolle, si dhe të trajnimit të brendshëm të mësuesve dhe instruktorëve.*

- e) Krijimit të një mekanizmi kombëtar për *orientimin profesional dhe këshillimin për karrierën*, me mbështetjen edhe të partnerëve socialë.

4. Nga pikëpamja e burimeve njerëzore të AFP:

Zhvillimi i kompetencave mësimdhënëse dhe menaxhuese të personelit të AP, nëpërmjet:

- Krijimit të një mekanizmi institucional për *kualifikimin (pre-service)* mbi bazat e pedagogjisë dhe psikologjisë, të mësuesve dhe instruktorëve të rinj të AP.
- Fuqizimit të mekanizmave institucionale aktualë (në nivel qendror dhe nivel shkolle) për *trajnimin e vazhduar (in-service)*, metodik dhe profesional, të të gjithë mësuesve e instruktorëve të AP.
- Fuqizimit të mekanizmave institucionale aktualë për trajnimin e drejtuesve të shkollave profesionale në lidhje me veçoritë e menaxhimit në këtë sektor.

5. Nga pikëpamja ligjore-financiare:

Plotësimi i kuadrit ligjor-normativ të AP me ligje, vendime, udhëzime dhe rregullore të posaçme në mbështetje të të gjitha ndryshimeve reformuese në këtë sektor, nëpërmjet:

- Hartimit të një Ligji të posaçëm për “Kuadrin Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale” si dhe i akteve nën ligjore në mbështetje të këtij komponenti të rëndësishëm për një sistem modern të AFP.
- Krijimit të një mjedisi ligjor më të përshatshëm për *zhvillimin e AP jopublik*.
- Krijimit të një mjedisi ligjor që lejon *angazhimin më të madh të shkollave në veprimtari ekonomike*, me qëllim rritjen e cilësisë së përgatitjes së nxënësve dhe krijimin e të ardhurave shtesë.

6. Nga pikëpamja e infrastrukturës së AP:

Zhvillimi sasior dhe cilësor i mjediseve dhe mjeteve mësimore në mbështetje të rritjes së parashikuar cilësore dhe sasiore të ofertës së AP, nëpërmjet:

- Rinovimit të mjediseve ekzistuese për mësimin teorik e praktik në shkollat profesionale.
- Pajisjes me bazën e nevojshme *materiale/didaktike* për mësimin teorik e praktik.

- Krijimit të *shkollave të reja* në ato rajone ku kërkesa është më e ndjeshme (ose shndërrimi i disa shkollave të përgjithshme në shkolla profesionale). Sigurisht që kjo do shoqëruar edhe me ndërhyrje të tjera në nivel shkolle (ristrukturime ndërtesash, krijim repartesh pune të reja dhe pajisje të atyre ekzistuese, rishikim i kualifikimeve që ofrohen, ndryshime në personelin e shkollave).
- *Optimizimit të shpërndarjes dhe madhësisë së shkollave* (krijimi i shkollave profesionale rajonale ose kombëtare), për të përshtatur më mirë ofertën me kërkesën dhe për të ulur kostot e këtij shërbimi publik. Kjo do të thotë që pas riorganizimit (fundi i vitit 2008), të rritet numri mesatar i nxënësve për shkollë, nga 380, që është aktualisht, në 700-1000 nxënës. Kjo do të mund të realizohej me rikonstruksione, shtesa, bashkime shkollash, lirim të mjediseve të zëna forcërisht, si dhe me shfrytëzim më të mirë të kapaciteteve ekzistuese.
- *Institucionalizimit të bashkëpunimit midis AP, formimit profesional dhe biznesit për të shfrytëzuar reciprokisht me efektivitet infrastrukturën e këtyre aktorëve në funksion të përgatitjes profesionale të nxënësve dhe kursantëve.*

Të gjitha këto si dhe ndërhyrje të tjera reformuese që nuk përmenden më lart, do të kontribuojnë në *ngritjen e dukshme cilësore të AP dhe plotësimin e objektivit sasior që në 4 vitet e ardhshme të dyfishohet pjesëmarrja në këtë sektor. Që të përmbushen këto objektiva, ato duhet të mbështeten me plane veprimi konkrete dhe realiste.*

Pjesa B

MATRICA E POLITIKËS: ÇËSHTJET E RËNDËSISHME, OBJEKTIVAT, PËRFITUESIT, TREGUESIT MONITORUES DHE AFATET

Në këtë pjesë përvijohen aktivitetet kryesore, objektivat, treguesit monitorues, rreziqet, supozimet si dhe afatet e përgjithshme. Informacioni për këtë pjesë gjendet në përshkrimet e fushave përkatëse në pjesën A. Veprimtaritë kryesore të identifikuara duhet të radhiten sipas prioriteteve dhe vijimësisë për një zhvillim progresiv. Matrica përmban çdo veprimtari të rëndësishme dhe identifikon pengesat e mundshme në arritjen e objektivave, veprimet e planifikuara për arritjen e këtyre objektivave dhe treguesit monitorues për të vlerësuar rezultatet.

B1 Qeverisja - Reformimi dhe forcimi i kapacitetit menaxhues

| Problemet kyçe | Objektivat | Përfituesit | Treguesit monitorues | Rreziqet dhe supozimet | Afati i propozuar |
|---------------------------|--|---|---|--|--|
| B.1.1 Reformimi i MASH | <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i qartë i vendeve të punës për të shmangur paqartësitë • Planifikimi dhe futja e sistemeve të menaxhimit të performancës • Zhvillimi i standardeve minimale të performancës • Marrja e masave ndaj atyre që kanë performancë të ulët. • Zhvillimi i skemave nxitëse për të inkurajuar nivele të larta të performancës • Transferimi i menaxhimit me bazë performance (MBP) në nivele rajonale, lokale dhe shkollore • Rritja e kapaciteteve për përdorimin e MBP në menaxhimin e MASH nëpërmjet trajnimit intensiv. | <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i MASH i vetëdijshëm për rolet e tij • Publik i vetëdijshëm për rolet e stafit të MASH • Shërbime të përmirësuara për stafin e DAR dhe ZA • Shërbime të përmirësuara për shkollat • Impakti në cilësinë e arsimit për fëmijët | <ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i legjislationit për të zbatuar MBP në MASH. • Përqindja e drejtorive të MASH të trajnuara në përdorimin e MBP deri në vitin 2006 • Përqindja e DAR dhe ZA që përdorin MBP deri në vitin 2008. • Reduktimi i kohës në marrjen e vendimeve dhe masa-ve në nivel qën-dror • Iniciativë e rritur e stafit në zgjidhjen e problemeve | <ul style="list-style-type: none"> • Zgjedhjet parlamentare mund të vonojnë procesin • Emërimi i personelit nuk bazohet në kualifikimet dhe performancën • Ndryshimi i praktikave mund të kërkojë shumë kohë • Mungesa e angazhimeve të MASH në mbështetje dhe sigurim të kritereve të nevojshme legislative . | <ul style="list-style-type: none"> • Ristrukturimi i niveleve qën-drore të përfundojë në vitin 2006 • Të gjitha institutet, agjencitë dhe qendrat e lidhura me MASH do të adaptojnë MBP deri në vitin 2007. • Nivele rajonale dhe të tjerat deri në vitin 2008. |

| | | | | | |
|--|---|---|---|--|--|
| <p>B.1.2 Decentralizimi</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i politikave të qarta për funksionet e MASH që do të decentralizohen • Zhvillimi i udhëzimeve të qarta për DAR dhe ZA, të cilat pranojnë rolet e decentralizuara • Zhvillimi i kapaciteteve për të përdorur të dhëna për planifikim në nivel lokal <p>Zhvillimi i procesit të raportimit dhe nivelit të përgjegjshmërisë brenda dhe midis drejtorëve</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Stafi qëndror në MASH • Stafi i DAR, ZA dhe i pushtetit vendor (PV) • Grupet e tjera të interesit • Prindërit dhe nxënësit | <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimet e reja mbi politikën të miratuara nga kabineti • Përqindja e detyrave të identifikuar, të menaxhuara nga MD (Menaxhimi i Decentralizimit) • Numri i mundësive që krijohen për trajnim | <ul style="list-style-type: none"> • Mungesë vullneti për të ndarë pushtetin • Trajnim i pamjaftueshëm i personelit • Mungesa e besimit dhe përgjegjësisë nga grupet e interesit • Nuk vlerësohen plotësisht funksionet shtesë të përgjegjësive qëndrore dhe lokale të menaxhimit | <p>Udhëzimet dhe funksionet që do të decentralizohen janë miratuar deri në vitin 2005</p> <p>50% e funksioneve të miratuara do të decentralizohen deri në vitin 2007.</p> <p>100% e funksioneve të miratuara do të decentralizohen deri në vitin 2010.</p> |
| <p>B.1.3 Autonomia e shkollës</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i politikave të qarta për drejtorin e shkollës dhe bordin e saj. • Krijimi i kapaciteteve për të përgatitur planin zhvillimor të shkollës • Krijimi i shoqatave të prindërve dhe mësuesve dhe inkurajimi i komunitetit dhe prindërve për përgjegjësi ndaj shkollës • Zhvillimi i sistemeve cilësore të përgjegjshmërisë <p>Vendosja e indikatorëve të jashtëm të cilësisë në të gjitha nivelet</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Drejtorët e shkollave dhe mësuesit • Shoqatat e prindërve dhe mësuesve si dhe komuniteti lokal • Pushteti Vendor (PV) dhe grupe të tjera të interesit | <ul style="list-style-type: none"> • Numri i drejtorëve të trajnuar të shkollave • Numri i SHPM të krijuara dhe që mbështesin aktivitetin shkollor • Numri i planeve zhvillimore të paraqitura të shkollave • Vendosja e indikatorëve kombëtarë • Numri i drejtuesve të trajnuar të komunave | <ul style="list-style-type: none"> • Komunitetet nuk janë ende gati të marrin përgjegjësi • Drejtorët e shkollave dhe menaxherët e PV nuk janë të trajnuar mirë • Mekanizmat e financimit nuk funksionojnë mirë • Mungesë vullneti e PV për të alokuar fondet e miratuara për shkollat | <p>100 shkolla të përzgjedhura funksionojnë si shkolla autonome deri në vitin 2006</p> <p>50% e të gjitha shkollave funksionojnë si ente autonome deri në vitin 2010.</p> <p>100% e shkollave janë tërësisht ose pjesërisht autonome deri në vitin 2015.</p> |

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| <p>B1.4 Mena-xhimi i sistemeve të informacionit në sektorin e arsimit</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i kuadrit të politikave për EMIS • Zhvillimi i specifikimeve dhe suporit për sistemin • Identifikimi i tipit të dhënave që do të mbliidhen dhe burimit të tyre • Zhvillimi i niveleve të aksesit dhe i procedurave të autorizimit • Zhvillimi i procedurave të analizës dhe raportimit dhe drejtoritë përgjegjëse <p>Zhvillimi intensiv i stafit dhe trajnimi i specializuar</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Menaxherët dhe politikëbërësit në nivel qendror (MASH) • Menaxherët dhe politikëbërësit në nivel rajonal-DAR, ZA dhe PV • Zyrtarët e planifikimit dhe hartimit të buxhetit • Personat përgjegjës për monitorimin e cilësisë | <ul style="list-style-type: none"> • Eshtë vendosur niveli i infrastruktu-rës dhe paisjeve. • Shtrirja e trajnimit për stafin teknik • Shtrirja e trajnimit për stafin profesio-nal • Cilësia e të dhënave të mbledhura • Tipi i analizës së kryer • Cilësia e raporteve të përgatitura mbi bazën e të dhënave për zhvillimin e politikave | <ul style="list-style-type: none"> • Pajisje dhe infra-strukturë e papër-shtatshme • Trajnim i pamjaf-tueshëm dhe jo i specializuar për stafin lokal • | <p>EMIS funksio-non plotësisht në nivel Qendror në vitin 2006</p> <p>EMIS funksio-non në 50% të shkollave dhe në zyrat rajonale deri në vitin 2008.</p> <p>EMIS funksio-non në 100% të shkollave dhe në zyrat rajonale deri në vitin 2010.</p> |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|---|---|---|---|
| <p>B.1.5 Rapor-timi dhe siguri-mi i cilësisë</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të stafit me dispozita për apelime • Zhvillimi i nivele-ve të ndryshme të raportimit për performancën e stafit • Zhvillimi i sistemeve të vlerësimit të bazuara në evidenca • Përshtatja e treguesve të performancës së MASH me ato të ministrive të tjera si dhe me treguesit ndërkombëtarë | <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i MASH • Sindikatat dhe shoqatat e tjera profesionale • Stafi i DAR, ZA dhe PV • Drejtorët e shkollave dhe mësuesit • Publiku i gjerë | <ul style="list-style-type: none"> • Struktura dhe udhëzime për monitorimin të miratuara formalisht nga MASH • Rregullsia dhe cilësia e raporteve të vlerësimit të drejtorive • Auditim i jashtëm nga MASH | <p>Miratimi i indikatorëve objektivë të cilësisë</p> <p>Frika nga reagimet kur raportohet për cilësinë e dobët dhe nivelin e ulët të performancës</p> | <p>Udhëzimet e vlerësimit për stafin dhe njësitë organizative të miratuara dhe zbatuara deri në vitin 2006.</p> <p>50% e drejtorëve të drejtorive dhe shefave të sektoreve zbatojnë vlerësimin e sta-fit dhe sigurimin e cilësisë deri në vitin 2008.</p> <p>100% e drejtorëve të drejtorive dhe shefave të sektoreve zbatojnë vlerësimin e stafit dhe sigurimin e cilësisë deri në vitin 2010.</p> |
|--|--|---|---|---|---|

B.2 Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor (mësimdhënie/nxënie)

| Çështjet kryesore | Objektivat | Përfituesit | Indikatorët monitorues | Rreziqet dhe supozimet | Afatet kohore të propozuara |
|----------------------------------|---|---|---|--|--|
| B.2.1 Zhvillimi i kurri-kulës | <ul style="list-style-type: none"> Hartimi i një korni-ze të përgjithshme kurrikulare kombë-tare (KKK) Strukturimi i arsimit parauniversitar me objektiva të përshtatshëm të mësimnxënies Racionalizimi i lëndëve dhe orëve për nivelet e klasave (ngarkesa mësimore). Zhvillimi i politika-ve për hartimin e kurrikulave të lëndë-ve me zgjedhje dhe kurrikulës gjithëpërfshirëse. Zhvillimi i planeve të reja mësimore du-ke rishikuar për-mbajtjen lëndore dhe përvijimi i vi-jueshmërisë horizontale dhe vertikale Zhvillimi i politikës dhe proceseve për ta reshtuar arsimin bazë në rrugën e arsimit profesional | <p>MASh dhe planifikuesit e SKZHES</p> <p>Institucionet e arsimit para-universitar.</p> <p>Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve</p> <p>Mësuesit dhe drejtorët e shkollave</p> <p>Nxënësit dhe prindërit</p> <p>OJO-të e vendit dhe të huaja, të përfshira në inovacione kurrikulare</p> | <p>Debate ndërsek-torale për korni-zën kurrikulare kombëtare.</p> <p>Korniza kurrikulare kombëtare e hartuar dhe e miratuar nga qeveria</p> <p>Listë e re e hartuar dhe e miratuar e lëndëve dhe orëve mësimore për lëndë e për çdo klasë</p> <p>Zhvillimi, miratimi, eksperimentimi dhe zbatimi i një procesi dhe përmbajtje të re plan mësimor-përmbajtje</p> | <p>Mungesa e kapacitetit dhe/ose an-gazhimit nga ana e IKS për të drejtuar reformën kurrikulare</p> <p>Vazhdon për-dorimi i kon-cepteve dhe metodave të vjetra</p> <p>Tensioni i shkaktur nga lën-dët tradicionale të kombinuara mund të çojë në shkëputjen e tyre nga reforma</p> | <p>KKK është hartuar dhe miratuar deri në 2005</p> <p>Planet mësimore fillore të zhvi-lluara, eksperimentuara dhe zbatuara deri në 2010</p> <p>Planet mësimore të arsimit të mesëm të zhvilluara, eksperimentuara dhe zbatuara deri në vitin 2015.</p> |

| | | | | | |
|---|---|--|---|--|--|
| <p>B.2.2 Zhvillimi i profesionit të mësuesit</p> | <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i kapaciteteve për të parashikuar kërkesat për mësues Forcimi i Qendrës Arsimore të Trajnimit dhe Kualifikimit (QATK) Rishikimi i kurrikulës së trajnimit të mësuesve për përbajtjen dhe procesin Rishikimi i kushteve për punësimin e mësuesve Shqyrtimi i modeleve të reja dhe alternative të trajnimit të mësuesve Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi i mësuesve Trajnimi gjatë punës dhe rrjetet profesionale | <p>EMIS, SAPP, MASH</p> <p>QATK</p> <p>Drejtorët e shkollave dhe mësuesit</p> <p>Siguruesit e trajnimit të mësuesve</p> <p>Shkolla dhe komunitetet e pafavorizuara</p> <p>Prindërit dhe nxënësit</p> | <p>Të dhënat EMIS të krijuara dhe raporti mbi kërkesën dhe ofertën e një rajoni</p> <p>Përshkrime të qarta të vendeve të punës për QATK dhe emërimi në bazë merite</p> <p>Miratimi i MBP dhe realizimi i 12 vlerësimeve mujore</p> <p>Janë hartuar dhe miratuar kompetencat e mësuesve plus programet e kualifikimit</p> <p>Krijimi i bordit të akreditimit dhe procedurat e akreditimit të mësuesve aktualë</p> <p>Krijimi dhe vënia në efikasitet të paktën 5 shoqatave të mësuesve</p> | <p>Mungesa e angazhimeve dhe gadhëmerisë për të ndërmarrë aktivitete</p> <p>Mungesa e mirëkuptimit për kërkimin më të fundit në zhvillimin e profesionit të mësuesit</p> <p>Marrja në kohë e miratimit ligjor për akreditimin e mësuesve, shpërblimeve të bazuara në merita, etj.</p> <p>Pajisja e të gjithë mësuesve aktualë me njohuri dhe aftësi për të zbatuar kurrikulën e re</p> | <p>Përshkrimi i vendeve të punës të QATK dhe emërimi i stafit deri në vitin 2005.</p> <p>Hartimi i kompetencave të mësuesve për nivele dhe lëndë të ndryshme deri në vitin 2006</p> <p>Hartimi, miratimi dhe organizimi i programeve të trajnimit fillestar dhe gjatë punës të mësuesve, deri në vitin 2006.</p> <p>Akreditimi i mësuesve dhe shpërblimi i bazuar në merita janë miratuar dhe vënë në efikasitet deri në 2010.</p> |
| <p>B.2.3 Hartimi i teksteve shkollore</p> | <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i përbajtjes dhe skemës metodike Koordinimi i kërkesës dhe ofertës së teksteve shkollore Menaxhimi i ofertës dhe kërkesës së teksteve alternative Privatizimi i botimit të teksteve shkollore Zhvillimi i mekanizmave për mbulimin e kostos së teksteve shkollore | <p>Nxënësit dhe mësuesit</p> <p>Autorët e teksteve</p> <p>Planifikuesit në MASH</p> <p>MASH dhe Drejtoritë Arsimore</p> <p>Shtëpitë botuese</p> <p>Drejtorët e shkollave dhe prindërit</p> | <p>Janë miratuar politikat dhe procedurat për hartimin e teksteve shkollore</p> <p>Është siguruar trajnimi për autorët e teksteve shkollore</p> <p>Lidhja e të dhënave për tekstet shkollorë me EMIS</p> <p>Janë miratuar politikat dhe procedurat për mbulimin e kostos.</p> | <p>Mungesë vullneti e autorëve për të hequr dorë nga librat e vjetër</p> <p>Mungesa e vlerësimit për rëndësinë e strukturës instrukionale</p> <p>Kundërshtimi nga shtëpitë botuese për të ndaluar vazhdimin e botimit vjetor</p> <p>Rezistenca për të mos paguar librat</p> | <p>Politika e re e hartimit dhe botimit të teksteve shkollore është miratuar deri në 2006</p> <p>Raporti i EMIS përmbledh kërkesën për tekstet shkollorë në vitin 2006</p> <p>Grupi i parë i librave për përpunim dhe miratimi i tyre për botim në vitin 2007</p> <p>Finalizimi mbi mbulimin e kostos dhe pilotimi në 2008.</p> |

| | | | | | |
|--|--|---|--|--|---|
| <p>B.2.4 Burimet alternative mësimore</p> | <ul style="list-style-type: none"> Hartimi i standardeve minimale për bibliotekat me libra reference Hartimi i standardeve minimale për numrat dhe tipat e teksteve alternative, CD etj. Zhvillimi i politika-ve për bibliotekat e shkollave Zhvillimi i politika-ve për përdorimin e Internetit si një mjet kërkimi | <p>Nxënësit dhe mësuesit</p> <p>Autorët e teksteve MASH dhe Drejtoritë Arsimore</p> <p>Shtëpitë botuese dhe kompanitë e TI</p> <p>Drejtorët e shkollave dhe prindërit</p> | <p>Sigurimi i trajnimit për hartuesit e burimeve alternative</p> <p>Janë zhvilluar dhe miratuar politikat dhe procedurat për librat alternative</p> <p>Janë zhvilluar dhe miratuar politikat dhe procedurat për bibliotekat e shkollave dhe shërbimet me internet</p> | <p>Paaftësia për të kontrolluar cilësinë dhe rrethësinë</p> <p>Drejtuesit e shkollave nuk vlerësojnë nevojat për burime shtesë</p> <p>Mosfinancimi nga buxheti i kostove për mirëmbajtje dhe sistem interneti</p> | <p>Është miratuar politika e burimeve dhe teksteve alternative deri në 2005</p> <p>Përgatitja dhe qarkullimi i listës minimale të burimeve alternative deri në 2006</p> <p>30% e shkollave kanë libra alternative të mirë dhe burime mësimore</p> |
| <p>B.2.5 Provimet dhe monitorimi</p> | <ul style="list-style-type: none"> Forcimi i kapacitetit të QKAVP për të kryer me sukses detyrën Hartimi i politikave dhe procedurave për monitorim dhe vendosje indikatorësh Zhvillimi i kapacitetit të QKVP për të hartuar e realizuar studimin e krahasimit dhe për të vendosur indikatorët Zhvillimi rigoroz dhe i besueshëm i provimeve kombëtare për klasën e 9-të (përfundimi i arsimit të detyruar) plus provimi i maturës Zhvillimi i kapacitetit të QKVP për të hartuar dhe vendosur indikatorë ndërkombëtarë | <p>Stafi i QKVP</p> <p>Prindër dhe nxënës</p> <p>Universitetet dhe institucione të tjera pas shkollës së mesme</p> <p>Drejtorët e shkollave dhe qeveria vendore</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së MASH</p> | <p>Stafi i trajnuar i QKVP për vlerësimin dhe monitorimin e arsimit</p> <p>Hartimi dhe pilotimi i provimit kombëtar për klasën 9 për kurrikulën e re</p> <p>Hartimi i politikës dhe procedurave për zhvillimin e provimeve të maturës</p> <p>Marrëveshje formale me universitetet dhe institucione të tjera pas shkollës së mesme për të përdorur një provim të veçantë për hyrje në universitet</p> | <p>Moskuptimi sa duhet i vlerësimit arsimor</p> <p>Paaftësia për të siguruar publikun lidhur me besueshmërinë dhe integritetin e provimeve</p> <p>Paaftësia për të negociuar me universitetet për të pasur një provim të përbashkët mature</p> <p>Mungesa e analizës transparente dhe raporteve mbrojtës</p> | <p>Realizimi i trajnimit për krijimin e kapaciteteve, deri në 2005</p> <p>Hartimi dhe eksperimentimi i provimit kombëtar të klasës së 9 në vitin 2006, dhe zbatimin i plotë në 2008</p> <p>Marrëveshja për një provim të përbashkët mature, deri në 2006</p> <p>Pjesëmarrja në vendosjen e indikatorëve rajonalë deri në 2007</p> <p>Hartimi dhe eksperimentimi i provimit kombëtar të klasës së 9 deri në 2010 dhe zbatimin i plotë deri në 2011</p> |

B3 REFORMA FINANCIARE PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

| Problem et kyçe | Objektivat | Përfituesit | Indikatorët monitorues | Rreziqet dhe supozimet | Afati kohor i propozuar |
|---|--|---|---|---|---|
| B. 3.1 Përbërja e buxhetit të arsimit parauniversitar | <ul style="list-style-type: none"> Hartimi nga ana e MF, MASH dhe PV i një përshkrimi transparent dhe të detajuar të kontributeve financiare të çdo grupi interesi. Financim i ndarë sektoral në grant bllok dhe me buxhet të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar | <ul style="list-style-type: none"> MASH, MF dhe PV Bordet e shkollave dhe komunitat | <ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i kontributeve i shprehur me përqindje Procesi i regjistrimit të informacionit i miratuar formalisht si një veprim i përhershëm | Mospranimi i MF për të bërë publik informacionin e detajuar të financimit | <ul style="list-style-type: none"> Identifikimi i nevojave të specifikuar financiare nga MASH për planifikim deri në 2005. Rënia dakord dhe miratimi i procedurës së raportimit midis MF dhe MASH deri në 2006 |
| B. 3.2 Insitumentat e transferimit të fondeve të buxhetit | <p>Ndarja e granteve bllok në aktivitete specifike të MASH si zëra para-lele</p> <ul style="list-style-type: none"> Rritja e fleksibilitetit dhe barazisë së modelit të financimit mbi bazën e modelit të hartuar të financimit për nxënës Realizimi i rishikimit të pjesës së PV për financimin e arsimit dhe procesit të përgjegjshmërisë për të siguruar mirëmbajtjen e rregullt Rishikimi i shpenzimeve periodike të menaxhuara në nivel qendror në dritën e procesit të decentralizimit Rishikimi i detajuar i procesit të përgjegjshmërisë për të rritur transparencën dhe efikasitetin në sistem Trajnimit plotë në menaxhimin e planifikimit të buxhetit dhe raportimit | <ul style="list-style-type: none"> Drejtoria ekonomike në MASH dhe sektorët e financës të DAR Shkollat dhe rajonet Menaxherët e financimit të arsimit Auditorët e menaxhimit financiar dhe MF Të gjitha grupet e interesit në fushën e arsimit | <p>Miratimi zyrtar i afateve kohore për MASH dhe MF</p> <p>Udhëzimet për raportin e buxhetit të ri të hartuar dhe të miratuara</p> <p>Raporti për zbatimin e një modeli financiar-mi për nxënës</p> <p>Ndryshimi dhe zbatimi i procedurave të raportimit të buxhetit të PV</p> <p>Marrëveshja e rishikuar për funksionet që do të decentralizohen</p> <p>Miratimi i sistemeve të raportimit dhe i shkallës së përgjegjshmërisë ndërauditive</p> <p>Sigurimi i trajnimit të detajuar për aspekte të veçanta.</p> | <ul style="list-style-type: none"> Procesi mund të vonohet nëse të dhënat nuk bëhen të disponueshme Mungesë gadishmërie për të përfshirë zërat paralelë në buxhet Modeli gjithëpërfshirës "për nxënës" mund të mos arrijë konsensusin e nevojshëm Transparenca në rritje e shpenzimeve të planifikuara dhe aktuale të pushtetit vendor mund të shihet me sy jo të mirë nga PV Mosmarrëveshje për funksionet që duhet të decentralizohen Trajnimit i detajuar mund të mos sigurohet në kohën e duhur | <p>Raportimi i detajuar dhe transparent i buxhetit deri në 2006</p> <p>Detajimi dhe transparenca e kontributit të PV në buxhet deri në 2006</p> <p>Delegimi i funksioneve të decentralizuara deri në 2007</p> <p>Hartimi dhe diskutimi i modelit të ri të financimit "për nxënës" deri në vitin 2007</p> <p>Sistemi i llogarisë dhe i financimit të plotë, të detajuar dhe transparent është miratuar nga MASH deri në vitin 2010</p> |

| | | | | | |
|---|--|--|---|---|--|
